



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opština Rahovac/Municipality of Rahovec



01 Nr. 07/23

Rahovec, 19.7.2023

Ftohen anëtarët e Kuvendit Komunal, që të marrin pjesë në mbledhjen e shtatë (7), e cila do të mbahet më 31 korrik 2023 (e **hënë**), me fillim në orën **10:00**, në sallën e KK Rahovec.

Për këtë mbledhje, propozoj këtë:

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave Komunale në Vrajakë;
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës në Vrajakë;
5. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave komunale në Xërxë;
6. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së komunës në Xërxë;
7. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për themelimin e komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuara;
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-vendimit për miratimin e memorandumit të mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të Strehimores “Shtëpia e Sigurt”;
9. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshimit dhe i plotësimit të vendimit 01 Nr.408/22, i datës 28.12.2022, për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.263/22, i datës 25.1.2022 për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
10. Shqyrtimi dhe miratimi i ndryshim-plotësimit të vendimit 01 Nr.265/22, i datës 25.1.2022, për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB);
11. Shqyrtimi dhe miratimi i vendimit 01 Nr.326/22, i datës 31.5.2022, për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
12. Shqyrtimi i Raportit Financiar janar - qershor 2023;
13. Shqyrtimi i Raportit të ZKA-së, për vitin 2022;
14. Shqyrtimi i Raportit nga Drejtoria e Arsimit rreth përfundimit të vitit mësimor 2022/2023;
15. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
16. Shqyrtimi i Informatës nga Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale;
17. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e Planit për Mirëmbajtjen e Hapësirave të Hapura Publike në komunën e Rahovecit;
18. Shqyrtimi i Informatës mbi realizimin e Planit të punës së Zyrës së Prokurimit janar – qershor 2023
19. Shqyrtimi i Raportit 6 mujorë të Këshillit të Fshatit Hoçë e Madhe;

KRYESUESI I KUVENDIT

Arbër Zenuni



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e rregullt e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më **27.6.2023 (e martë)**, me fillim në orën **10:00**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **zt. Defrim Kafexhiu**. Në fillim konstatoi se ka kuorum për mbajtjen e mbledhjes.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! I nderuar Kryetar i Komunës, **zt. Smajl Latifi**, Nënkyetar **zt. Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të Kuvendit Komunal, drejtorë të drejtorive komunale, zyrtarë, përfaqësues të KFOR-it, medie, të nderuar qytetarë të Komunës së Rahovecit, kjo është seanca e gjashtë (6) për këtë vit kalendarik. Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 19 qershor, për këtë seancë, ka përgatitur këtë:

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;
3. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmuor (janar – qershor 2023) të kryetarit të Komunës;
4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) – 2024 - 2026;
5. Shqyrtimi i propozimvendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023;
6. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00386-1, ZK-Pastasellë;
7. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00364-0, ZK- Polluzhë;
8. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01031-0, ZK- Polluzhë;
9. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00331-0, ZK - Mrasor;
10. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01987-0, ZK- Opterushë;
11. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00050-0, ZK Opterushë;
12. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01015-12, ZK-Xërxe;
13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01313-3, ZK-Rahovec;
14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.63/23, i datës 28.4.2023, për vënien në mbrojtje të “Kanionit të Drinit të Bardhë”;
15. Shqyrtimi i Raportit të komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe të lagjeve urbane;
16. Shqyrtimi i informatës nga Drejtoria për Shërbime Publike;

Kryesuesi – Ky është rendi i ditës i përgatitur për seancën e sotme. Nëse dikush prej anëtarëve ka ndonjë koment, propozim apo vërejtje, mund ta merrni fjalën.

Sejfullah Sejfullahu – Faleminderit kryesues, përshëndetje për ju, për kryetarin, për kolegët. E kam një kërkesë e cila ka të bëjë me një ndihmë financiare për një djalë të një dëshmori, konkretisht Muhamed Malsori, i cili vuan nga një sëmundje shumë të rëndë. Në këto momente gjenden për mjekim në francë pa asnjë mbështetje institucionale. Po i drejtohem kryetarit që brenda mundësive buxhetore t’i ndihmoni për shërim, përveq që është ndihmë financiare, është edhe obligim moral. Pres mbështetje, faleminderit.

Kryetari – Përshëndetje për kryesuesin, anëtarët e kuvendit, drejtorët, nënkryetarin, përfaqësuesit të LMT-së, OSBE-së dhe të gjithë pjesëmarrësit. E mirëkuptoj shqetësimin që e paraqiti Sejfullah Sejfullahut. Visarin e njohim,

është në gjendje të rëndë shëndetësore dhe ka nevojë për ndihmën tonë. Ajo çfarë dua të them është që unë jam menjëherë i gatshëm t'i ndihmoj, aq sa më lejon lidhi dhe rregullorja, gjithashtu do të kontaktoj me shumë njerëz tjerë të vullnetit të mirë që janë të gatshëm t'i ndihmojnë. Kjo pikë nuk dëshiroj të jetë pjesë e rendit të ditës, sepse deri më tani, prej që jam unë kryetar komune, janë tri raste që i kemi ndihmuar me kuvend dhe nuk është që kemi kaluar “më së miri” për shkak se jemi të ndërgjegjshëm që ka shumë raste të cilat nuk kemi mundësi t'i shtyejmë tutje me kuvend. Unë, që sot jam i gatshëm t'i ndihmoj dhe i kisha ftuar anëtarët e kuvendit që mos ta kemi si pikë të rendit të ditës dhe si pjesë të debatit, sepse edhe unë i kam disa raste që poashtu janë familjarë të dëshmorëve dhe invalidëve dhe që mund ta hapim një shteg që nuk ka fund. Sa i përket ndihmave momentale, secilën kërkesa e kemi aprovuar dhe e kemi ndihmuar. E kam në plan të shkoj për vizitë te Visari, duke i ofruar ndihmë institucionale dhe ndihmë në bashkëpunime me njerëzit e vullnetit të mirë. Atij i urojmë shëndet dhe shërim të plotë e të shpejtë.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues, asambleistë, ekzekutiv, të gjithë të pranishmit këtu në sallë. Rreth kësaj kërkesë po më vie keq që duhet edhe t'ia lakojmë edhe emrin për shkak të rrethanave që i ka. Më e udhës do të ishte nëse Sefa do të dakordohet me kryetarin se cilat janë mundësitë, por sidoqoftë në qfarë formati që vlerësohet kjo kërkesë, ne si asambleistë jemi të gatshëm ta përkrahim, pa dashtë që kjo punë të lexohet politikisht. E dyta, kryetar, po kërkoj që pika tre e rendit të ditës (raporti 6 – mujor) të shtyhet për muajin korrik, për faktin që e meriton një trajtim pak më serioz, sepse materiali ka ardhur në email dje në ora 14:16 dhe nuk besoj që dikush ka arritur ta lexojë seriozisht. Kërkoj mirëkuptim që të tërhiqet sepse e meriton të lexohet dhe diskutohet pak më gjatë.

Kryetari – Faleminderit Burim! Ju siguroj që në kapacitetet e mia, ndihmën e ka të plotë rasti konkret. Personalisht do të kontribuoj, të mos jetë pjesë e kuvendit sepse po ndodhin presedane, por bashkë me ekipin tim dhe me juve do ta ndihmojmë, gjithashtu e kam ndërmend të shkoj për vizitë atje. Do të ndahemi të kënaqur edhe në raport me Visarin edhe me familjen e tij. Sa i përket pikës së tretë, ju ftoj për mirëkuptim sepse e kemi detyrim ligjor të kalojmë në qershor, përndryshe absolutisht keni të drejtë. Në web faqe zyrtare publikuar dhe e di që është nuk keni pasur kohë për shqyrtim, por është kriter ligjor. Si temë mund ta diskutojmë edhe në korrik.

Sejfullah Sejfullahu – Kryetar, ka 2-3 muaj që jam me këtë stres, e kuptoj gjithashtu edhe “sikletin” tënd që po ndihesh keq dhe e vlerësoj gatishmërinë tënde, por ai ka nevojë për një ndihmë pak më të madhe, me kërkesë diku rreth 10 mijë € nëse ekziston mundësia.

Kryetari – Faleminderit Sef, nuk është çështje që ne nuk duam dhe ju them që unë do ta marr përsipër dhe bashkë e bëjmë ndryshe këtë punë dhe ndoshta do t'i bëjmë edhe më shumë. Do ta përdori edhe autoritetin tim duke iu kërkuar ndihmë njerëzve të vullnetit të mirë. Do t'i ndihmojmë aq sa kemi mundësi, brenda dhe jasht komunës. Ju ftoj për mirëkuptim dhe për shkak të ndjeshmërisë kisha dashur ta mbyllim këtë temë.

Kryesuesi – Faleminderit kryetar! Atëherë me këtë rast kam qenë i njoftuar edhe unë më herë dhe pajtohem plotësisht me ndjeshmërinë e rastit dhe me rëndësinë e ndihmës financiare dhe në fund të fundit është kuvendi ai që vendosë për epilogun e këtyre propozimeve. Te çështja e raportit të kryetarit edhe në KPF e kemi përfshirë në rend dite me 19 qershor për arsye të performancës si kriter. Në muajin korrik mund ta krijojmë një hapësirë ku mund t'i diskutojmë çështjet prej raportit të punës së kryetarit, sa i përket propozimit të Sejfullahut, besoj që duhet ta vendosim në votim.

Burim Krasniqi – Te propozimi i Sefës, mos të vijmë në situatën e votimit ose mosvotimit edhe pse çdo që vie në kuvend unë edhe LDK e votojmë me vlerë maksimale që i lejohet asamblesë. Nuk është mirë ta bëjmë një situatë ku ne mund të biejmë në “provokim” në kuptimin e sjelljes tonë, jo në “provokim” në kuptimin e përkrahjes sepse këto janë dy gjëra. Rekomandoj që Sefa dhe kryetari të dakordohen për formën e përkrahjes ose nëse e vendosim në votim, LDK voton pro.

Hasan Përbiqi – Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, kryesues, kolegë, drejtorë. Siç e cekën parafolësit që është një rast i shumë i ndishëm dhe ne si asamblesistë jemi në pozitë jo të lakmueshme. Në emër të grupit, kërkoj një konsultim të vogël, ndoshta një pauzë pesë minutëshe.

Kryetari – Ju lutem edhe një herë për mirëkuptim secilin prej jush, në radhë të parë Sefën si propozues. Unë thash – ma lini në diskrecionin e kryetarit dhe ekipit të tij. Do të jemi shumë komunikues edhe me anëtarët e kuvendit, do t'i ndihmojmë dhe nuk ka nevojë për më shumë konsultime.

Ilir Pallqa – Secili anëtarë ka të drejtë të bëjë propozime! Fjalën e fundit prapë e ka Sejfullahu, nëse dëshiron ta tërheqë propozimin apo jo. Nëse dëshiron që propozimi të votohet, duhet ta cekë edhe shumën apo jo? Mos të votohet blanko.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për juve, kryetarit, anëtarët e kuvendit të komunës, drejtorët e drejtorive, pjesëmarrësit. Sefa e bëri një propozim me vend, askush nuk e konteston këtë. Mirëpo, në sqarimin që e dha kryetari mendoj që, më mirë është ta ndjekim rrugën që e propozoi kryetari sepse më shumë mjete mblihen në atë mënyrë sesa ta votojmë ne si kuvend. Gjithashtu edhe kryetari i LDK-së, Burim Krasniqi e tha që do të mundohemi t'i ndihmojmë, sigurisht edhe grupet tjera. Në këtë rast kryesuesi nuk ka faj sepse çdo propozim prej anëtarëve të kuvendit ai është i obliguar ta vendos në votim, mirëpo ne duhet t'ia lehtësojmë kryesuesit punën dhe në këtë rast, Sefa duhet të dakordohet me kryetarit dhe të pajtohen me formën e kryetarit dhe vazhdojmë tutje.

Kryesuesi - Faleminderit Rasim! Mundohem ta ndiej përgjegjësin edhe të Sefës edhe të Arbrit, që vijnë prej të njëjtit vendbanim, sikurse Visari. Visarit i uroj shërim nga kjo sprovë. Besoj që me premtimin e kryetarit dhe ju ftoj të gjithëve me mundësitë që i kemi të kontribuojmë secili. Propozimin e Sefës, po e marr përgjegjësinë t'ia bartim kryetarit dhe po e lë valid, që varësisht prej punës së kryetarit përgjatë ditëve në vijim do ta shqyrtojmë. Nëse nuk ka pasur efekt puna e kryetarit, propozimin do ta vendosi në votim në seancën tjetër. Është e rëndë edhe për mua ta them në këtë formë, por besoj që duhet të vazhdojmë tutje me rendin e ditës. Atëherë po e vendosim rendin e ditës në votim si të tillë, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet rendi i ditës për mbledhjen e sotme.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë kritikë apo pyetje rreth procesverbalit?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash aprovohet procesverbali i seancës së kaluar.

2. Pyetjet dhe përgjigjet në pyetjet e kuvendarëve;

Arbër Zenuni – I nderuar kryetar, zt. Smajl Latifi, kryesues zt. Defrim Kafexhiu, drejtorë, kolegë. Fillimisht po ju drejtohem me një kërkesë në lidhje me PZHK-në (faza në të cilën ka mbetur), sepse është me rëndësi të veçantë për komunën tonë. Në cilën fazë është duke u zhvilluar PZHK-ja dhe a janë marrë parasysh kërkesat e ndryshme që janë parashtruar nga bizneset e ndryshme dhe qytetarët?... Kërkesa e dyta ka të bëjë me ndërtimin e stadiumit në Krushë të Madhe në pjesën sipër fshatit, kërkesa ime është që kompania që lidh kontratë me komunën ta bëjë një projekt të ri, duke i hyrë në punë edhe zhvillimit të agro turizmit edhe sportit. T'i bëhet kërkesë zyrtare kryeministrit Kurti, që në mbledhjen e ardhshme të të dy qeverive ta mbajnë në shtëpinë muze “Ukshin Hoti”. Kërkesë tjetër është edhe pastrimi i segmentit të ujërave të zeza përgjatë rrugës “Muhamed Malsori”, sepse gjatë reshjeve të shiut, banorët e këtij komuniteti maltretohen nga vërshimet. Kërkesa tjetër ka të bëjë me sinjalizimin e rrugës Krushë e Madhe – Nagac – Hoçë e Vogël – Brestoc – Rahovec.

Edona Kryeziu – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! I nderuari kryesues, faleminderit për mundësinë e fjalës. I nderuari kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë. Objekti i ri i shkollës në fshatin Xërxë është duke u ndërtuar, ka apo nuk ka fonde të mjaftueshme nuk dua të fokusohem në atë pikë, por në një segment tjetër. Kur është bërë plani i shkollës, komuniteti i fshatit fare nuk është pyetur. Plani arkitekturor ka ardhur i gatshëm pa asnjë matje faktike, gjë që ka sjellë disa telashe paraprakisht. Këshilli drejtues i shkollës në mars 2023, në adresë të kryetarit ka protokolluar një kërkesë, ku kërkohet: Rregullimi i fushës sportive me rrethoja, vendosja e një rubineti për ujë të pijshëm për nxënësit e shkollës, të vendoset një shtresë e hollë e zhavorrit përkohësisht për ecje të nxënësve, duke e ditur që ky projekt do të stërgjatët. Në këtë kërkesë këshilli i lartëcekur nuk ka marrë asnjë përgjigje. Për fund, kam një pyetje për ty kryetar, duke pasur parasysh rëndësinë e ndërtimit të shkollës në Xërxë, nga informatat që kemi, materialet që po hiqen (asfalti dhe kubëzat) janë hedhur në një hapësirë apo tokë bujqësore që është në komasacion. Kjo është një shkelje ligjore dhe komuna si organ mbikëqyrës ka lejuar një gjë të tillë. Më intereson, nëse ka pasur reagim nga inspektoriati në lidhje me këtë çështje.

Burim Krasniqi – Faleminderit shumë për mundësinë e fjalës. I kam disa pyetje! E para ka të bëjë me Drejtorinë e Urbanizmit. Fjala është për projektin e Sheshit Qëndror dhe projekti i devijimit të përrockës të lumit Duhlllo. A ka një plan dinamik të zbatimit të këtyre punimeve, duke pasur parasysh që kanë mbetur edhe dy javë kur fillon sezona e ardhjes së bashkatdhetarëve. Çka do të ndodh me trafikun në Rahovec, nëse rr.“Sheh Myhedini” dhe rruga përball Hotel Parkut edhe më tutje mbetet e bllokuar! Kërkoj që të merret seriozisht kjo temë dhe këto rrugë të jenë në funksion të plotë që mos të temi një bllokadë totale. Te Drejtoria e Bujqësisë: Sa kam informata, te ndarja e pajisjeve bujqësore në 2023, janë pajisje të përfituesëve të vitit 2021, nëse nuk qëndron kërkoj falje, por kështu e kam informatën. Pse ka ndodh që për dy vite të mos ndahen pajisjet bujqësore dhe a ka edhe përfitues tjerë të vitit 2020-2021 që janë në listën e përfituesëve, por ende nuk i kanë marrë pajisjet bujqësore? Kërkoj një informatë të shkruar për seancën e radhës, sa ka qenë vlera e pajisjeve për njësi (sa është paguar një frezë, multikultivator, spërkatëse?)

nga komuna. Te Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik: Është fjala për panelat solare për prodhimin e energjisë elektrike. A e ka të paraparë komuna e Rahovecit orientimin se ku do t'ia mundësojë investitorëve privat ndërtimin e hapësirave me panel solar për prodhim të energjisë? Një shteqësim e kam te Drejtoria e Arsimit! E dimë që shumë shkolla kanë probleme me kuadro (matematikë, fizikë) dhe është mandati i dytë i qeverisjes. Sot kur ka dalë lista e përfutësëve të bursave, nuk po e shoh që i keni dhënë prioritet drejtimeve për të cilat ka nevojë Komuna e Rahovecit. Kam pritë që do t'u jepni vullnet studentëve duke i shtyrë ata të shkojnë për studime në lëndë specifike që i duhen Komunës së Rahovecit, gjegjësisht arsimit., duke iu ndarë bursa të plota për studime (2000€ në vit). Kërkoj që të kontaktoni shkollat, t'i shihni nxënësit që kanë talent për matematikë, fizikë dhe lëndë tjera specifike, të dakordoheni me ta dhe t'i vazhdojnë studimet po në ato lëndë që i duhen komunës.

Sinan Kryeziu – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. E marr detyrimin të flas në lidhje me ndërtimin e shkollës në fshatin Xërxë. E para e punës, shkolla është propozuar nga DKA-ja që të ndërtohet aty te rruga kryesore dhe pasi që këshilli i fshatit që ka legjitimitet të plotë, e që edhe unë jam pjesë e tij dhe këshilli i prindërve, kanë diskutuar dhe kanë dalur me një konkludim që aty ku është duke u ndërtuar shkolla, aty kemi vendosur për ndërtim.

Shqipe Kryeziu – Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, përshëndetje për të gjithë. Përderisa i përkas fushës së arsimit, dëshiroj ta falënderoj kryetarit për përkrahje që iu bënë nxënësve me anë të shpërndarjes së bursave. E inkurajoj të vazhdojë.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, drejtorë të drejtorive, kolegë, përfaqësues të KFOR-it, OSBE-së. Realisht i kam dy pyetje dhe një shqetësim. Pyetje për drejtorin e Bujqësisë, Berat Duraku, rreth ngritjes së shqetësimit sa i përket rrugëve fushore, sidomos rruga që lidhet me Nagac dhe rruga e “Para-katunit”. Këto janë kërkesat kryesore të banorëve të atij lokaliteti dhe kur pritet që të fillojnë punimet? Çështja tjetër ka të bëjë me Drejtorinë e Shërbimeve Publike, rreth ndriçimit publik në rrugën kryesore është duke u ndalur shpesh herë. A e mirëmbanë ndonjë kompani këtë ndriçim? Si dhe në lagjen “Lezi - Krasniqi”, kur pritet që të investohet në atë lagje ndriçimi publik? Kurse, shqetësimi ka të bëjë me cenimin e pasurisë së qytetarëve nga vjedhjet e ndryshme dhe gjithashtu është duke u cenuar edhe siguria publike. Konsideroj që si asamble komunale, bashkë me qeverisjen komunale duhet të propozojmë masa konkrete në bashkëpunim me organet e rendit, për të krijuar një ambient më të sigurt. (të ketë kamera të sigurisë ose shpeshtimi i patrullimeve policore).

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues! I nderuar kryesues, kryetar, kolegë, nënkryetar, drejtorë, të pranishmit në sallë. Pse nuk ka intensitet më të lartë nga kompanitë kontraktuese për rregullimin e rrugëve. Kompanitë janë të njëjta, kanë kontratë dhe paratë do t'i marrin me doemos. A mund ta gjeni një formë që kompanitë të jenë më serioze dhe më të përgjegjshme në këto çështje? E dyta, a mund ta merrni si prioritet të paktën një klub sportiv ta bëjmë protagonist në Kosovë, duke gjetur forma të ndryshme për përkrahje, jo vetëm subvencione. Kryetari i përmendi më herët autoritetin e tij, është një formë alternative ta përdorë edhe këtu. Për fund, kryetar, 1+1 bëjnë 2, 2+1 bëjnë 3 dhe boll janë tri mandate, të nominoj për deputet në mandatin tjetër sepse nuk ke më çka t'i jep kësaj shtëpie.

Eqrem Spahiu – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për të gjithë. Unë i kam dy kërkesa. Njëra ka të bëjë me një parking te varrezat e qytetit të Rahovecit sepse pas çdo vdekje mortore, kemi ndalim dhe bllokim të rrugës. A ekzistojnë mundësitë të paktën me zhvorr të krijohen mundësitë e krijimit të një parkingu aty afër. Kërkesa tjetër është rreth ujërave atmosferikë që prej pompës “Fatmiri” e deri te fusha e sporti derdhen, a ka mundësi devijimi te pjesa e Brestocit? Një pyetje tjetër për drejtorin e urbanizmit, para disa dite ka filluar punimi i mureve të Burimit në Optrushë, ku po bëhet dekorimi i mureve me rrasa të gurit dhe jo me gurë dekorues, apo jo?

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues! E mora fjalën për një kritikë për drejtorin e shërbimeve publike dhe ekzekutivin bashkë! Pse nuk dilni të tregoni sesi është puna në rrugën “Sheh Myhedini” (në qendër)? Drejtori në këtë rast duhet të tregojë që ky projekt është në bashkëfinancim me ministrinë, operatori i ka përfunduar 95% të punimeve dhe ministria nuk po i ekzekuton.

Bejtullah Deliu – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, zv. kryetar, drejtorë, kolegë, media, pjesëtarë të KFOR-it. Kjo është seanca e dytë që ekzekutivi nuk ka nevojë për përgjigje më duket, po krijohet një farë debati në mes asambleistëve e në fakt pyetjet i drejtohen ekzekutivit dhe drejtorive të caktuara. Një vërejtje e vogël që më ra në sy është në rrugën “Halil Hamza”, sinjalizuesit nuk janë të vendosur në mënyrë të rregullt. Është një shtëpi e vjetër aty afër, nëse nuk gaboj e familjes Hasku, qytetarët kanë marrë iniciativë t'i bëjnë me dorë të lirë sinjalizuesit për kahje të rrugës.

Edona Kryeziu – Faleminderit kryesues! E kërkoja fjalën në momentin që Sinani ishte këtu, por meqenëse doli jashtë, nuk ka problem sepse e di që ia përcjellin. Po ndihem e detyruar t’i replikoj Sinanit. Para dy muajve, Sinani i ka parë shumë mirë punën dhe parregullsitë e kryetarit, mirëpo tani i ka hedh syve pluhur dhe ne e dimë arsyen. Sa për informacion jam në kontakt të vazhdueshëm me qytetarë e sidomos me të fshatit Xërxë dhe çdo shqetësim që e gris në kuvend, nuk e bëj pa u konsultuar me dikë.

Drilon Mustafa – Përshëndetje kryetar, kryesues, të nderuar kolegë. Për Drejtorinë e Administratës rreth lehtësirave për bashkatdhetarët që do të vijnë në pushime. Ne e dimë që komuna (administrata) ka aplikuar një standart të ri “One Stop Shop”. Sa do të ndikojë kjo dhe çfarë lehtësira tjera do të ketë për bashkatdhetarët. Në fund, për Iliri: Kryetari nuk ka qejf t’i ketë gjërat “tek”, por “çift” edhe një mandat tjetër jemi kënde.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues! E kam një shqetësim të qytetarëve gjithashtu, rruga Fortesë – Celinë ka disa vite që në të njëjtat vende dëmtohet. Mendoj që komuna ka ekspertë të mjaftueshëm që ka mundësi të bëhet muret mbrojtëse që mos të ketë rrëshqitje të dheut dhe të rregullohet. Nuk është mirë që këtë shqetësim ta ngisim për çdo vit, me të vërtetë është bërë e mërziqshme. Me mundësi, është mirë që tani para ardhjes së mërgimtarëve të rregullohet i nderuar drejtor i shërbimeve publike.

Florida Bajraktari – Faleminderit kryesues! Përshëndetje për juve, kryetarin, drejtorat, kolegët. Një pyetje për drejtorinë përkatëse. Fshati Brestoc, konkretisht rruga e “Diturisë”, aty afër kalon një përrockë dhe një pjesë e saj ka mbetë e parregulluar, një pjesë është kryer vitin e kaluar. Kur do të fillojë të ndërtohet pjesa tjetër?

Burim Krasniqi – Po më vjen keq që po e them, por me të vërtetë po dalin keq drejtorat kur nuk “e hapin gojën”, këtu folin veq shefat, drejtorat nuk bën. A i konsideroni të paaftë (që unë e konsideroj të kundërtën), së paku te drejtori i urbanizmit që e kam koleg të drejtimit profesional dhe nuk e ka problem që din të përgjigjet, apo është një lloj arroganca të tregohet autoritet superlativ në raport me gjithë të tjerët dhe me dhënë përgjigje në diçka që s’i takon hiç! Konsideroj që të lejohen drejtorat të përgjigjen vet, mundet edhe kryetari i komunës sepse është menaxher i drejtorave, por të përgjigjet shefi i asambleistave është diçka që vetëm në Kore të Veriut mund të ndodh.

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues! Shfrytëzoj rastin të gjithëve t’ju uroj festën e Kurban Bajramit që është nesër. Në seancën e kaluar Burimi ka përdorë gjuhë joparlamentare ndaj asambleistave, nëse përgjigja ime qenka e formës së tillë, atëherë çka është ajo që ka thënë në seancën e kaluar! Fjalën e kemi të lirë si unë, si çdo asambleistë tjetër këtu. Ne e zgjedhim atë që e folim sepse në fund ne mbajmë përgjegjësi për vete. Shfrytëzoj rastin t’i them Burimit, që në opinionin e auditimit, komuna jonë ka dalur e pakualifikuar (mirë).

Albnor Mullabazi – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, kolegë drejtorë, asambleistë, të nderuar pjesëmarrës në kuvend. Rreth pyetjes së Arbrit për Planin Zhvillimor Komunal, komuna i ka përfunduar të gjitha punët sa i përket PZHK-së, e kemi mbajtë shqyrtimin publik, ka shumë komente dhe kërkesa të arsyeshme të qytetarëve të përfshira në plan. Jemi duke e pritur vendimin prej ministrisë. Plani Zhvillimor është dorëzuar në ministri dhe besoj që gjatë seancës në muajin korrik do të vie për votim te ne. Te pyetja e Burimit sa i përket zonave të caktuara për panele për energji të ripërtrishme, e kemi pjesën mbi Opterushë (mbi 170 ha), në mal mbi Rahovec dhe në një pjesë në fshatin Radostë. Përveq energjisë së ripërtrishme me panele, i kemi të paraparë edhe Mullinjtë e Erës. Kërkesa e planit dinamik për punimet në Shesh Qëndror (jam mbikëqyrës i punimeve në atë projekt). Sheshi ka plan dinamik. Në gjashtë mujorin e parë përveç pengesave me KRU- Gjakovën, faktor që mos me arrit dinamikën e punës kanë qenë edhe kushtet atmosferike. Te pyetja e Eqrem Spahiut në lidhje me rregullimin e “Vrellës” është projekt me dekorim me specifikat që janë duke u zhvilluar (veshje me gurë). Përveç “Vrellës” në atë zonë e kemi edhe një projekt që ka të bëj me rregullimin e një parku.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryetar dhe kryesues! Përshëndetje për të gjithë anëtarët e kuvendit. Arbri pyeti për çështjen e trajtimit të ujërave të zeza: Kemi filluar një procedurë të re nga granti i performancës për trajtimin e kolektorit dhe do të jetë një zgjidhje e përhershme e kanalizimit. Burimi pyeti për çështjen e planit dinamik të punimeve dhe të njëjtën kohë iu jap përgjigje tre anëtarëve të kuvendit, Bejtullahut dhe Ilirit, për 3 muaj që kanë filluar punimet në qendër, janë kryer 310 metra kanal monolid me diametër të betonit 2.5m me 1.5m. Poashtu është vendosur një gyp F500 për ujëra të zeza, gjithashtu është bërë një ndërrim i gypit të ujit të pijshëm 300m, d.m.th jemi në fazën përfundimtare duke i kryer punët në kohë rekorde. Sot pas orës 2 do të fillojmë me asfaltimin (shtresa e parë) e asaj pjese në qendër. Sa i përket sinjalizimit, ndoshta nuk e keni vërejtur por në hyrje dhe dalje të qytetit janë vendosur shenja vertikale, për shkak që nuk lejohet transporti i rëndë. Sidoqoftë ka sinjalistikë. Rasimi pyeti

për çështjen e rrugës, është e vertetë, kemi pasur probleme pronësore me pronarë privat në vendosje të trajtimit të ujërave të shiut dhe pa vendosjen e trajtimit për ujëra të shiut, ajo rrugë nuk do të zgjidhet kurrë.

Nora Boshnjaku – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, asambleistë, përfaqësues të mediave, monitorues nga OSBE. Në pyetjen që Edona Kryeziu e parashtrojë lidhur me një problematikë nga operatori Euro-ing (hudhja e disa kubëzave) në një zonë në fshatin Xërxë. Jam saktësisht e informuar për rastin, inspektorët kanë dalë në terren dhe si dëshmi edonës do t’ia tregoj edhe procesverbalin. Operatori është obliguar që në një afat optimal zonën ta kthejë në gjendje të mëparshme. Nëse nuk i përgjigjet urdhërit të inspektoriatit komunal, i njëjti do të ndëshkohet sipas legjislacionit në fuqi.

Kryetari – Faleminderit! I falënderoj të gjithë për kontributin në diskutim. Stadiumi në Krushë të Madhe: Faleminderit Arbër, mund të bëjmë projekt të ri sepse kemi kompani për hartim të projekteve, mirëpo, shpresojmë që Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit nuk e ka harruar Rahovecin dhe i rikthen kodet për të cilat kemi diskutuar herave tjera. (Stadiumi i qytetit, stadiumi në Krushë të Madhe, Stadiumi në Ratkoc, Palestra në Krushë të Madhe). Te Shkolla Fillore e Mesme e Ulët “Hamëz Thaqi”, ne nuk e bëjmë asnjë projekt pa u konsultuar me drejtorinë e shkollës. Kompania për hartimin e projekteve e ka përshtatur në bazë të matjeve në terren dhe besoj që sfidën e kemi të çështjet financiare, jo të cilësia e ndërtimit. Bursat: Një konkurs që është shpallur në Komunë të Gjakovës për matematikë, nuk ka pasur asnjë aplikim, Gjakova ka 88 fshatra, plus qytetin. As në Rahovec nuk ka matematicientë dhe shumë pak ka njerëz që i zgjedhin këto drejtime të shkencave natyrore. Kësaj radhe me bursa i ndihmojmë duke i stimuluar edhe nxënësit e shkollave të mesme, kuptohet duke u bazuar në kriteret të përcaktuara në konkurs. Te vjedhjet dhe plaqkitet e shpeshta, jemi duke bashkëpunuar me policinë e Kosovës dhe në emër të juajin e ftoj komantantin e stacionit të policisë që t’i shtojë patrullimet, përkundër që ne e kemi rritur sigurinë përmes ndriçimit publik. Dinamikën e punimeve edhe vetë e kemi shqetësuar dhe sfidë njëkohësisht, duke u bazuar në reshje dhe në disa probleme të vogla të kontratat e vjetra për shkak të çmimeve. Dinamika e punimeve është rritur dukshëm sepse presioni jonë te operatorët po rritet çdo ditë dhe moti është përmirësuar mirë. Te rruga Fortesë – Celinë, pa u zgjidhur problemi i ujëra atmosferik është bukur problem, mund të bëjmë edhe mure aty, por ujin e kemi problem, sidomos në Celinë. Zgjidhje ka, nëse e krijojmë një partneritet më konstruktiv me pronarët aty.

Rasim Fazliu – Kryetar, unë jam i vetëdijshëm që problemi qëndron te ujërat, por te segmentet që po flas unë, aty duhet ta bëni një mur mbrojtës dhe e parandalojmë shembjen e dheut.

Kryetari – Faleminderit Rasim, unë jam që ta incizojmë edhe një herë terrenin, megjithëse duhet shumë mure mbrojtëse. Ilir, “faleminderit që u bëre anëtar i Aleancës e më nominove për deputet”! “Une do të propozoj për kryetar të partisë në qendër, në kuvendin e ardhshëm të aleancës.” D.m.th. jemi për punë më të mëdha e jo vetëm për punë të komunës, vlerësim që nuk e kam pritur, më befason për të mirë. Sa i përket subvencionimit të klubeve, do ta dëshmojmë që edhe në vitin e ardhshëm sikurse sivjet, do të ketë rritje të mbështjetjes.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues! Faleminderit për përgjigjet e kufizuara që i mora. Unë nuk thash t’i përkrahim më shumë klube, por klubet që kanë vëmendje më të mëdha. Ju mund të organizoheni edhe për Tennis ta bëni ndonjë spektakël, por ne e dijmë vëmendjen e tenisit te ne. Me pesë komuna që kufizohet Rahoveci – Klina, Malisheva, Suhareka, Gjakova dhe Prizreni, Ne fatkeqësisht nuk po ngelim, por jemi duke shkuar te poshtë. Vitin e kaluar e kemi pasur të paktën një klub në superligë, tani nuk e kemi asnjë (te sportet me vëmendje më të madhe). Uroj që keni ndonjë plan strategjik për të ardhmen, duke e përdorur edhe autoritetin e kryetarit (të krijoni tryezë me biznesmenë dhe sportdashës, ose ta privatizoni klubin). Kryetari për punë të mëdha është për deputet, i cili ka rol legjislativ dhe është i mirë për të foluar, për të punuar nuk është. Për punë më të mëdha të të folmes, jo për veprime. Për Rahovec e ka dëshmuar edhe në kohë të vështira që ka qenë në gjendje ta japë edhe jetën, por prej jetës nuk ka më qfarë të japë.

Eqrem Spahiu - Faleminderit kryesues! Kryetar, nuk m’u përgjigje për parkingun te rruga e varrezave të qytetit.

Kryetari – Faleminderit Eqrem, nuk është që nuk kemi menduar, bile kemi problem edhe me ujin, i cili po shkon në varreza dhe duke punuar në këtë drejtim. Sa i përket parkingut, nuk ka vend për një të tillë. Ilir, në çfarëdo forme jam në gjendje ta përdori autoritetin tim, për t’u fuqizuar sporti në Rahovec dhe të kemi një traditë të arritjeve pozitive sportive. (Në basketboll dhe futboll e kam dëshmuar, në hendboll sapo kam filluar). “Çka nëse kam qenë i gatshëm ta jap jetën, pas jetës jam i gatshëm ta jap kontributin gjatë gjithë jetës” – më duket fola pak si Albin Kurti.

Kryesuesi – Atëherë po e përmbylim pikën e dytë të rendit të ditës. Dua t’ju drejtohem juve anëtarëve të kuvendit, rrjedhimisht edhe qytetarëve të Komunës së Rahovecit për aktivitetin e kuvendit komunal dhe te çështja e aktivitetit

përbrenda seancave të rregullta të anëtarëve të kuvendit. Për mua, sinjerisht është e dhimbshme mungesa fizike e anëtarëve të kuvendit edhe tani, kemi një mungesë prej më shumë se dhjetë anëtarëve të kuvendit përgjatë seancës. Pas kësaj, jemi njëra prej komunave që monitorohemi prej një projekti që e zgjedhin anëtarin më aktiv. Përveç seancave të rregullta, kryetari dhe e ka mbajtur takimin publik për 6 – mujorin e punës dhe në cilësinë e anëtarit të kuvendit mora pjesë dhe pashë që aty ishin shumë pak anëtarë nga kuvendi. Kur në takimet e kryetarit ka një pjesëmarrje të kënaqshme, rrjedhimisht edhe qytetarët e kanë mundësinë të përfshihen në vendimmarrje të institucioneve lokale. I ftoj të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit që përmes pjesëmarrjes së tyre nëpër konsultimeve publike dhe dëgjime buxhetore të bëhen pjesë e vendimmarrjes, jo vetëm në formën fizike, por duhet ta kenë një qasje më të hapur me kërkesa të vazhdueshme. Aktualisht me ligjin e ri të pagave, nuk kemi mekanizëm për penalizimin e anëtarëve të kuvendit që nuk marrin pjesë në seanca të kuvendit, por kjo nuk d.m.th që ne nuk kemi përgjegjësi ndaj atyre që na kanë votuar. Propozoj që prej seancën së ardhshme, anëtarët e kuvendit që mungojnë në seanca paraprake, do t’iu jap fjalën në fillim të seancës për dhënien e arsytimit që kanë munguar paraprakisht, duke e bërë këtë para qytetarëve të komunës së Rahovecit.

Vazhdojmë me një pauzë deri në ora 13:30 ...

Kryesuesi – Të nderuar të pranishëm, po vazhdojmë me pjesën e mbetur të seancës, kemi mbetur te pika e tretë e rendit të ditës.

3. Shqyrtimi i Raportit gjashtëmujor (janar – qershor 2023) të kryetarit të komunës;

Kryetari – Përshëndetje kryesues, anëtarë të kuvendit, drejtorë, nënkryetar, përfaqësues të mediave. Raporti i ka 40 faqe, është më i shkurtër për nga faqet, por kjo nuk do të thotë që është punuar më pak. Raporti përmban pjesën hyrëse, pjesën e zotimeve, synimeve, prioritetëve, raportet e zyrave të kryetarit (Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim, Zyrës së Auditimit të Brendshëm, Zyrës Ligjore, Zyrës së Prokurimit, Zyrës për Barazi Gjinore, Zyrës për Integritet Evropian, Zyra e Personelit, Zyra për Përfaqësim Ligjor, Zyra e Informimit dhe Sektori për Lektorim. Janë 12 drejtori dhe secila prej tyre e ka raportin përkatës. E veçanta e këtij raporti, që përveç të të arriturave dhe rezultateve është që ne i kemi përshkruar edhe sfidat dhe aspektet që na bëjnë të ecim më ngadalë. Ky raport përmban edhe diçka që ka të bëjë me të hyrat komunale, vetëm në 6 mujorin e parë i kemi 1 milion e 81.000€ ose mbi (70%) e realizimit të planit. Në bashkëpunim me kuvendin kemi realizuar edhe disa plane që kanë qenë mungesë në të kaluarën. Të arritur e kemi “One Stop –shop” që është një shërbim që mundëson disa shërbime të merren në një mjedis. Ky raport është publik, i publikuar në ueb-faqen e Komunës së Rahovecit dhe në faqen zyrtare të kryetarit të komunës. Besoj që raporti duhet të diskutohet me vërejtje, këshilla dhe plotësime, me qëllim të përmirësimit të punës sonë të përbashkët.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues, e kam veç një vërejtje teknike te titulli i raportit, të bëhet: Raporti 6-mujor i punës dhe mospunës, janar-qershor.

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues! Pa dashur të ndalem te detajet e raportit. Është një punë jashtëzakonisht që është bërë nga drejtoria e Financave në aspektin e të hyrave. Njëkohësisht një pyetje për drejtorin, qka ka ndikuar që të hyrat e rregullta komunale të rriten në një masë kaq të madhe?

Kryetari – Raportin vjetor të punës do ta titullojmë përafërsisht ksisoj: Raporti vjetor i punës së kryetarit të komunës – qeverisë komunale, raporti i punës i sfidave, i arritjeve, i reshjeve atmosferike, i pushimeve verore dhe i Bajramit të Madh dhe të Vogël! Urime Bajrami!

Afrim Limani – Përshëndetje për të gjithë! Hasan, konsideroj që janë tre faktor që kanë ndikuar në rritjen e ty hyrave vetanake të komunës, në rend të parë te tatimi në pronë. Vetëdijësimi i qytetarëve, vërejtjet e fundit që kanë rezultuar me sukses dhe faktori i tretë është që në atë periudhë i kemi shpërnda edhe faturat e tatimit në pronë (çdo faturë në adresë të tatimpaguesit).

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar. Paraprakisht shefi i grupit të asambleistave të LDK-së, propozoi që kjo pikë të shtyhet mirëpo, për hir të procedurave të transparencës që kërkohen, atëherë në pika të trasha e kemi lexuar raportin. Pajtohem në parim me mirëfunksionimin e administratës komunale në përgjithësi, por kam disa paqartësi në lidhje me prioritetet e për vitin 2023. Cilat janë prioritetet e filluar në 2023? Cilat nga prioritetet janë të përfunduara? Cilat janë në proces të implementimit? Kërkoj nga kryetari sqarime për prioritetet e realizuara në këtë 6 – mujor!

Burim Krasniqi - Faleminderit kryesues! Te raporti, kam disa komente te prioritetet e programit qeverisës. Te bujqësia: Është fakt që ka pasur subvencionim të pajisjeve bujqësore, mirëpo pres që raporti i ardhshëm të ketë rritje

të sipërfaqes mbjellëse, rritje të krerëve, gjedheve dhe lopëve. Te arsimit dhe shëndetësia: Pajtohemi plotësisht me investimet në shkollë, mirëpo është mirë të rritet qasja në raport me funksionimin e brendshëm të shkollave, rritje të cilësisë. Te trashëgimia kulturore: E kemi rastin e “Sahat Kullës” dhe mendoj që duhet t’i zbulojmë të mirat që i posedon Komuna e Rahovecit me qëllim të zhvillimit të trashëgimisë kulturore dhe njëkohësisht përfitimit të vizitës së turistëve. Sa i përket hapësirave publike që i keni të paraqitura si sfida, është fakt që ka ngecje të investimeve nga qeverisja qendrore, por besoj që duhet edhe qeveria lokale të ketë parasysh kapacitetet e investimeve në këtë sferë. Te burimet njerëzore dhe profesionale: Kapacitete profesionale ka, por të shtyhen pak më shumë me trajnime të ndryshme. Te Zyra e Prokurimit: Drejtori i Financave të obligimet kontraktuale na jep një kontrast shumë ndryshe me atë të raportit. Ke thënë që obligime kontraktuale janë mbi 15 milion €. Zyra e Prokurimit thotë i kemi pasur 45 aktivitete në vlerë prej 11.642.246 €! A nënkupton kjo që sot, Komuna e Rahovecit ka kontrata në vlerë prej mbi 27 milion €?! Kjo gjendje del kur i krahasojmë dy raportet, raportit të drejtorisë së Financave që ka ardhur deri në fund të 2022 dhe raportin 6-mujor të Zyrës së Prokurimit për vitin 2023. Te pjesa tjetër, faqe 11, thotë: janë 245 lëndë të mbetura përmbartimore, 119 të kontratës kolektive dhe 126 tjera janë të natyrës tjetër. Te Drejtoria e Bujqësisë, faqe 19 – subvencione dhe transfere thotë që janë të alokuara 629.566 € dhe janë të shpenzuara 390.270€, ky shpenzim a i ka mbuluar mjaftueshëm përfituesit e subvencioneve apo është i ndarë në dy faza? Te Drejtoria e Shëndetësisë: Objekti i QKMF-së është përruar, është punuar goxha por punimet vazhdojnë ende brenda, ka punë ende aty. Te Drejtoria e Arsimit, nuk më ka pëlqyer një gjë që, gruaja e drejtorit të shkollës bashkë me drejtorinë shkollës duke e prerë shiritin e qerdhes në Krushë. Nuk ka të bëjë me raportin, por Krusha ka figura më të mëdha sesa të shkojë një familje ta prejë shiritin e një shkolle. Te Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, thotë: Kemi përgatitur paramasën për projektin “Mirëmbajtja e shtigjeve të ecjes”, kjo është punë administrative dhe jo investim kapital. Ka aktivitete tjera që përsëriten, mund të jetë gabime teknike. Një kërkesë tjetër, te pjesa e profesionistëve kryetar, është mirë që t’i shfrytëzoni edhe kapacitetet e jashtme ose kuadrove profesionale, të cilat në një formë ose tjetër mund ta ndihmojnë komunën në zhvillim.

Kryetari – Faleminderit Lirigzon, megjithëse janë prioritetet për 4 vite, disa të fokusuara për vitin 2023: Sheshi Qëndror i qytetit, funksionalizimi i shtëpisë për të moshuar, mirëmbajtja të “Maja e Shkodranit”, mirëmbajtja e kullës për heronjt “Xhalal Hajda – Toni”, “Selajdin Mullabazi – Mici” dhe bashkëluftëtarëve Hamdi Hajrizi, Nezir Ymeri dhe Bektesh Haliti, Edukim dinjitoz i brezave të rinj, funksionalizimi i plotë i qerdheve ekzistuese, bursat për studentë, laboratorët dhe kabinetet nëpër shkollë, përkrahja e fermerëve me pajisje bujqësore, serra, stalla dhe impute bujqësore, rrugë fushore, përkrahje për pika të grumbullimit të qumështit, shërbime veterinarë periodike falas, konsulentë falas për bujq, ndërtimi i rrugëve të reja, ndërrimi i shtyllave elektrike, rritja e kapaciteteve inspektuese, investimi i stacionit të autobusëve në Rahovec, administratë efikase dhe të digjitalizuar (One Stop Shop), rritja e përkrahjes për OJQ dhe shumë prioritetet tjera janë duke ndodhur... Burimi i ngriti disa çështje, po i përgjigjem në parim: E para, ka gabime teknike se e kam vërejtur edhe vet, pa dashje ose me dashje na korrigjon ministria e Financave sepse është afancuar sistemi në këtë drejtim. Kemi obligime kontraktuale dhe jemi duke luftuar që të mos kthehen në obligime financiare pa pasur mbulesë financiare, ti ikim procedurave përmbartimore sepse përbaruesi ka kosto si dhe gjithashtu të marrim përkrahje financiare sa më shumë nga qeveria. Jam i vetëdijshëm dhe i ndërgjegjshëm që nuk jemi pa të meta dhe pa dobi.

Burim Krasniqi – Te çështja e obligimeve, vetëm edhe një herë që ka mundësi ta shikoni raportin që e ka bërë Zyra e Prokurimit dhe Zyra e Drejtorisë së Financës sepse është shumë alarmante.

4. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore (KAB) – 2024 - 2026;

Afrim Limani - Faleminderit kryesues! Përshëndetje kryetar, nënkryetar, asambleistë. Burim, ka mundësi që obligimet kontraktuale janë në atë vlerë, por nëse janë ashtu, janë brenda 2-3 apo 4 viteve. Nuk ka shancë që brenda këtij gjashtë mujori të jetë ashtu.

KAB-i komunal konsiderohet një dokument voluminoz dhe i përgatitun mjaftë mirë me të gjitha analizat e buxhetit 2024, 2025 dhe 2026. Këtu janë të përcaktuara synimet, zotime dhe prioritetet tona. E veçanta e këtij dokumenti është se për herë të parë e kemi përgatitë buxhetimin gjinor dhe në kategorinë e subvencioneve do të ndajmë buxhet për gjininë femrore. Buxheti për vitin 2024 është 20 milion e 34 mijë €, mallra dhe shërbime 6 milion, paga është 10 milion e 300 mijë, mallra dhe shërbime 2.466.000, komunalitë 370.000, në subvencione 890.000€. Të prezantuara janë synimet, zotimet dhe prioritetet në kuadër të të gjitha drejtorive.

Burim Krasniqi – Drejtor, te tabela nr.1 faqe 14, është interesant kur i sheh vlerat ndër vite. Nuk jam ekonomist, mund të gaboj dhe për atë arsye po pyes. Te rritja e bruto produktit vendor në 2026, vlerësimi është që ka 3.6% më pak se 2025 dhe 2024 dhe realisht thuhet që inflacioni do të bie në 2%, d.m.th është pak kontrast edhe të bie inflacioni edhe të bie rritja e bruto produktit vendor është e quditshme. Te numri i bizneseve të regjistruara: Është një trend i rënies i bizneseve të regjistruara, prej 2603 bizneseve që janë në 2023, keni thënë që në 2024 do të jenë 1845, në 2025 do të jenë 1656 biznese dhe në vitin 2026 do të jenë 1458. Pyes nëse ka ndonjë rrezikshmëri?! Te tabela nr.2 te të hyrat: Te taksa nga mbeturinat prej 2024-25-26 parashihen të hyrat. Në 2024 janë 170.000€, në 2023 zero, 2025 janë 200.000€ dhe në 2026 janë 200.000€, çfarë takse është kjo, sepse nuk e kam të qartë! Te tatimi në tokë ka rënie të tatimit në tokë, çka e bënë të ketë rënie?

Dafina Gashi – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar i komunës, nënkryetar, kolegë, drejtorë, media. Fillimisht përgëzoj ekzekutivin e komunës për procesin e konsultimeve publike rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore. Një e mirë është që është bërë specifikimi i buxhetimit gjinor dhe kjo do të rezultojë në përforimin më efikas të fondeve ekzistuese. Përkrahja e vazhdueshme për rininë ka qenë njëri ndër prioritetet të qeverisjes. Unë propozoj që në planifikimin e ardhshëm të buxhetit të bëhet krijimi i nënkodit buxhetor për rininë që mundëson fuqizimin direkt të rinisë dhe ndihmon në krijimin e hapësirave më të sigurta për zhvillimin e aktiviteteve.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues! Në rregull jemi me kornizën afatmesme buxhetore, veçse ne kemi në propozim për një ndryshim të vogël. Te subvencionet të planifikuara për drejtorinë e Kulturës Rinisë dhe Sportit janë 100.000€, kurse te subvencionet për bujqësi janë 400.000€. Ne propozojmë që 40.000€ nga bujqësia të barten te drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport. Në bujqësi të ngelin 360.000€, këtu të shtohen 40.000€ që është 40% i vlerës totale. Vlerë dinjitoze. Poashtu, përderisa ndarja e këtyre subvencioneve është në përgjegjësi të drejtorit të DKRS-së, i sugjeroj atij që nëse kalon ky propozim nga kuvendi, këto 40.000€ të jenë të destinuara për sport dhe të fokusuar vetëm në grupmosha – fëmijë. Ju lutem mos e neglizhoni këtë propozim. I ftoj asambleistët nga radhët LVV-së, LDK-së dhe PDK-së apo edhe ndonjë trimëresh ose trim nga radhët e AAK-së, që ka guxim ta votojë këtë radhë në përkrahje të rinisë.

Kryetari – Rritje e subvencioneve për Kulturë Rini dhe Sport është evidente dhe rritja e subvencioneve në përgjithësi është më e madhe për vitin që vjen. Sivjet i kemi 820.000€ subvencione, vitin e ardhshëm janë të planifikuar 890.000€. Mos ta harrojmë faktin që Kulturën Rininë dhe Sportin çdo herë e kemi subvencionuar edhe nga subvencionet e zyrës së kryetarit. Ato 40.000€ të propozuara, nëse është nevoja do t'i jap nga zyra e kryetarit. Subvencionet për bujqësi nëse do të kisha pasur mundësi do t'i rritja ende më shumë, sepse imputet bujqësore janë instrumente jashtëzakonisht të nevojshme për fermerët ndoshta edhe më shumë sesa një pajisje bujqësore. Për DKRS, vetëm në këtë vit, Zyra i Kryetarit i ka dhënë 47.100€. Ndërsa vitin e ardhshëm mund t'i jep edhe 60.000. Në atë që tha Burimi: Ne do të kemi një mënyrë tjetër të menaxhimit të mbeturinave nga viti i ardhshëm (projekt me JICA-n). Sa i përket zvogëlimit të numrit të bizneseve, kemi një rënie të numrit të tyre sepse janë eliminuar bizneset fiktive.

Burim Krasniqi – Trendi i zvogëlimit të numrit është i quditshëm sepse në pikën 1.4, faqe 25, në raportin 6-mujor thotë: Biznese të reja janë 83, të shuara janë 25, d.m.th ka më shumë biznese të reja sesa që janë shuar. Ose kjo informatë nuk është në rregull, ose ky trend nuk është planifikuar drejt sepse kanë mospërputhje kur krahasohen në mes veti.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues! Subvencionimi për bujqësi është rritur dhe vazhdimisht duhet rritur. Por, a po rriten pronat bujqësore apo veç klientela e AAK-së, (votat potenciale të AAK-së). Specifikisht i përmenda grupmoshat, kryetari foli për klubet dhe OJQ-të. I sfidoj asambleistët e AAK-së këtë radhë t'ia japim paratë Afrim Dinës dhe jo Berat Durakut, po flasim për 40.000€. Të rinjtë duhet t'i mbajmë këtu me organizimin e aktiviteteve.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues! Te sektori i bujqësisë dëshiroj ta pyes ekzekutivin, a është i paraparë sistemi i zgjerimit të ujitjes të tokave bujqësore, përkatësisht fshatrave Hoçë, Brestoc, Nagac.

Merisa Sharku – Përshëndetje për të gjithë! Përgëzime për ndarjen dhe fokusin në buxhetimin gjinor me rreth 45.000€ dhe me shpresë që është një start i mbarë dhe rritje sa më të madhe në vitet në vijim. Në seancat e mëhershme, njejtë si Iliri që kërkoi për sport, unë kam kërkuar që subvencionet 50% të shkojnë në bujqësi dhe 50% në artizanate. Te pika e zhvillimit të turizmit nuk e vërejtja si pikë monumentin “GRAPELAND”!

Kryetari – E para, prioritetet i cakton qeveria dhe kryetari i komunës sepse kështu është mandati. E dyta, cili është me më shumë prioritet, bujqësia apo sporti, dihet që Rahoveci është kryeqytet i bujqësisë, zonë e veçantë e interesit për bujqësi apo siç e tha Merisa, Grapeland. Do ta buxhetojmë edhe buxhetin për rini si nënkod, ashtu siç e kemi bërë me buxhetimin gjinor. Sa i përket “grapelandit”, kemi aplikuar në Ministri të Zhvillimit Rajonal dhe është pranuar projekti. Ato që i tha Burimi, gjithashtu edhe mua më duken paradoksale te tabelat e përmendura dhe kërkoj nga Afrimi për përmirësim dhe gjithashtu kërkoj që me këto vërejtje ta vendosim në votim. Te Lirigzoni rreth zgjerimit të sistemit të ujitjes: Faza e parë e rehabilitimit të sistemit aktual të ujitjes ka përfunduar, faza e dytë e përfshin zgjerimin e sistemit të ujitjes dhe më së shumti e kap Komunën e Rahovecit.

Ilir Pallqa - Faleminderit kryesues! Kemi keqkuptime konceptuale me kryetarin. Kryetari thotë që kur ne e shohim që na përfaqësojmë do t’i përkrahim. Kur arrijnë ata të na përfaqësojnë nuk kanë nevojë për përkrahje, sepse e kanë arritur nivelin e dëshiruar. Unë them t’i përkrahim grupmoshat, duke i përkrahur, i krijojmë dhe vjen koha kur na përfaqësojnë si komunë.

Kryetari – Ilir Pallqa, nuk kalon propozimi yt. Nuk e don ti më shumë rininë sesa unë (që i kam 52 vjet). Shkollat e futbollit dhe basketbollit i përkrahim çdo vit duke e rritur përkrahjen vit pas viti. Ky është programi, nëse të pëlqen e voton, nëse jo mos e voto. Nuk kam kohë të merrem me juve, që as A-në e kësaj pune nuk e kupton! Të gjithë ata që dinë të organizojnë diçka në lidhje me grupmosha të reja dhe gjëra tjera, do ta ketë përkrahjen time dhe të DKRS. Bjondina Kleqka - I nderuar kryesues, kryetar, nënkryetar, kolegë këshitarë dhe të pranishëm. Po ndërlidhem me këtë lloj sfidimi që po e përmend kolegu ynë Ilir. Dua të them që kjo nuk ka lidhje me sfidim, vetëm duhet kuptuar konceptin qeverisës të ndarjes buxhetore. Në vitin e parë kur kam qenë drejtoreshë, ne do të ishim vetëm me 40.000€ fonde për Kulturë Rini dhe Sport dhe në bashkëpunim me fondin e kryetarit që e posedon janë bërë plotësime deri në 140.000€.

Afrim Limani – Paraprakisht ju njoftoj edhe njëherë, sot kërkojmë nga ju të votoni kufijtë buxhetor dhe jo KAB-in si dokument. Duhet të votohet buxheti në shumën prej 20 milion e 34 mijë. Granti i përgjithshëm 18 milion e 160 mijë, buxheti i Hoçës së Madhe 29.000, shërbime rezidenciale 230.000 dhe ato pjesë që po i diskutoni në këtë rast janë të panevojshme sepse buxheti votohet në seancën e shtatorit. Burim, ti i kupton shumë mirë problemet ekonomike dhe të kam thënë që ta ofroj mundësinë në zyrën time të njoftoj akoma më shumë me disa të dhëna, jo që unë jam shumë më i ditur, por e kam përvojën dhe me dëshirë do t’i zbërthej gjërat. Të dhënat i kemi të marrur nga Enti i Statistikave të Kosovës dhe nga Banka Qëndrore dhe i kemi plasuar në këtë dokument. Është shumë e qartë te rritja e bruto produktit, për çdo vit shkon duke u rritur, në 2023 është 3.5%, vazhdon rritja 3.9%... Te zvogëlimi i bizneseve shënimet janë të sakta. Sa i përket pyetjes së Ilirit, do të ishte shumë mirë që subvencionet për Sport të rriten mbi 100 apo 200.000€, por ekziston rreziku që departamenti i buxhetit nuk na lejon. Këtë vit e kemi bërë një rritje rreth 80.000€ dhe kam frikë që edhe kjo rritje mund të mos lejohet. Diskutimi i buxhetit në shtator është temë e gjerë dhe mund t’i paraqitni shumë kërkesa dhe sugjerime.

Burim Krasniqi – Drejtor, shënimet për biznese, të lutem shikoni mirë dhe kurdo që i verifikoni na dërgoni informatën.

Kryesuesi – Faleminderit Burim! Atëherë propozimin e Ilirit duhet ta vendosim në votim dhe formën sesi e ka bërë propozimin nuk mund ta gjykojmë. Propozimi është bartja e 40.000€ nga drejtoria e Bujqësisë në drejtorinë e Sportit, specifikisht e ka cekur që subvencionimi të jetë për grupmoshat e reja. Po e vendosim në votim, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me 14 vota kundër, 7 vota “për” dhe votat tjera abstenim, nuk kalon propozimi i

Ilirit. Sipas rendit të ditës po e vendosim në votim Kornizën Afatmesme Buxhetore 2024-2026! Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me 19 vota “për” dhe votat tjera abstenim miratohet KAB-i 2024-2026.

5. Shqyrtimi i propozimvendimit për bartjen e mjeteve nga viti 2022 në vitin 2023;

Afrim Limani - Siç jeni në dijeni edhe ju, kjo pikë e rendit të ditës vjen për herë të tretë në kuvend. Arsyet e dini, qeveria ka marrë vendim që shuma e mjeteve të bllokohet, pastaj vendimi tjetër thotë që këto mjete mund të zhblokohen dhe ne detyrohemi ta vendosim në mbledhje të rregullt të kuvendit. Ju rikujtoj se shuma e bartur është 490.416€, pjesa e mjeteve nga fondi burimor 22, është 58.267€.

Burim Krasniqi – Drejtor, këtë pikë e kemi kaluar një herë në vlerë prej 479.989, më pas të vitit 2021 në muajin e 4 i kemi hequr dhe tani po i kthejmë përsëri. Tani janë rreth 10.000€ më shumë sesa vendimi i parë, a janë mjete që kan hy ndërkohë apo?...

Afrim Limani – Me barazimin e fundit që e kemi bërë me departamentin e buxhetit del që sipas tyre kemi rritje prej 10.000€.

Ilir Pallqa – Pasiqë më është lakuar emri prej drejtorit. Prej momentit që ka ardhë Sinani, te pjesa ligjore jeni bë pak më të mirë, por nuk bën ta harrojmë formë sesi ka ardhur Sinani, Shqipja dhe Florida. Sa i përket opozitës është për keqardhje, një herë në muaj i marrin 530€ dhe nuk kanë kurrfarë përgjegjësie para votuesëve. Është për keqardhje që jam pjesë e kësaj legjislature.

Kryesuesi – Atëherë po e vendosim në votim bartjen e mjeteve nga 2022 në 2023, kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Atëherë me 19 vota “për”, 1 votë kundër dhe të tjerat abstenim kalon bartja e mjeteve nga 2022 në 2023. Vazhdojmë me pauzë prej 15 minutave ... rikthehemi.

Hasan Përboqi – Faleminderit kryesues! Atëherë pasi që jemi para festës së Kurban Bajramit, propozoj që prej pikës së 6 deri te pika e 13 t’i votojmë si pako.

6. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00386-1, ZK-Pastasellë;

8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-01031-0, ZK-Polluzhë;

9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-00331-0, ZK- Mrasor;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, nënkryetar, kolegë, të nderuar anëtarë të kuvendit. Unë po i prezantoj shpejt, më pas i votoni një nga një. Janë tri prona që menaxhohen nga Agjencioni Pyjor i Kosovës, dallojnë me sipërfaqe dhe ne po kërkojmë nga ju që t’i shpallim me interes të përgjithshëm me qëllim të këmbimit që në të ardhme të bëhen terrene sportive. Bëhet fjalë për zonën kadastrale në Pastasel, Polluzhë dhe Mrasor me nga 6 ari (pika 6, 8, 9).

7. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes te përgjithshëm publik P-00364-0, ZK- Polluzhë;

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë për shpallje me interes të përgjithshëm pjesën e sipërfaqes së përgjithshme në hapësirë prej 2 ari e 10m. Në terren është rrugë faktike e kalueshme dhe po kërkojmë nga ju që ta shpallim me interes të përgjithshëm – rrugë publike, prona është në emër të Ibrahim (Zeqë) Hoti – Polluzhë.

10. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01987-0, ZK- Opterushë;

11. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00050-0, ZK Opterushë;

Afrim Oruqi – Janë dy parcela në zonën kadastrale në Opterushë, të dyjat janë në kufij ku veq janë duke u zhvilluar punimet për Zonën Ekonomike. Kërkojmë nga ju që t’i shpallim me interes të përgjithshëm sipërfaqen prej 6 ari prej pjesë së përgjithshme me nr. P-01987-0, në seanca tjera të marrim pëlqim për këmbim. P-00050-0, është sipërfaqe që menaxhohet nga pasuria shtetërore e Kosovës që menaxhohet nga ekonomia e pyjeve dhe po kërkojmë që ta shpallim interes të përgjithshëm 1 ha e 20 ari. Qëllimi është qasja në parcelën që po ndërtohet Zona Ekonomike.

12. Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01015-12, ZK-Xërxe;

Afrim Oruqi – Sipërfaqja e përgjithshme e kësaj parcele është 60 ari dhe ne kërkojmë nga ju që të shpallim interes të përgjithshëm 1 ari e 34m. Kjo sipërfaqe është në pronësi të Sylejman Hamdi Kryeziu. Si qëllim kemi këmbimin dhe e njëjta parcelë kufizohet me pronën komunale.

13. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01313-3, ZK-Rahovec;

Afrim Oruqi – Bëhet fjalë konkretisht për parcelën ku preket me projektin e Sheshit Qëndror. Në një seancë të kaluar kemi provuar me parcelizim të parcelës, kjo e drejtë garantohet me Hartë Zonale, e ne fatkeqësisht nuk e kemi ende hartën. Po provojmë ta ndjekim një rrugë tjetër ligjore, që është interesi i përgjithshëm duke qenë në dakordim të plotë me pronarët e parcelës. (Tasim Dula, Hysnije dhe Hajrulla Bahtjar Dula). Sipërfaqja e përgjithshme është 8 ari e 28m, ne kërkojmë nga ju që ta shpallim me interes të përgjithshëm pjesën e parcelës me sipërfaqe prej 4 ari e 46m. Në të ardhmen do të kërkojmë pëlqim për këmbimin e kësaj parcele me parcelë komunale.

Kryesuesi – Atëherë vazhdojmë me pikën e gjashtë: Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00386-1, ZK-Pastasellë, a ka dikush prej anëtarëve të kuvendit diçka për të thënë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet pika e gjashtë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e shtatë: Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00364-0, ZK- Polluzhë, a ka dikush prej anëtarëve të kuvendit diçka për të thënë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet pika e shtatë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e tetë: Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-01031-0, ZK-Polluzhë; , a ka dikush prej anëtarëve të kuvendit diçka për të thënë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet pika e tetë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e nëntë: Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik, P-00331-0, ZK- Mrasor, a ka dikush prej anëtarëve të kuvendit diçka për të thënë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet pika e nëntë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e dhjetë: Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01987-0, ZK- Opterushë, a ka dikush prej anëtarëve të kuvendit diçka për të thënë rreth kësaj pike?

Eqrem Spahiu – Faleminderit kryesues! Jemi në dijeni që punimet janë duke u zhvilluar në Zonën Ekonomike dhe cili është interesi i komunës për bartjen e kësaj prone?

Burim Krasniqi – Parcela 00050-0, a është muri mbrojtës në këtë parcelë sepse kam informacione që ka dalë jashtë kufijve të Zonës Ekonomike, apo planifikohet për diçka tjetër!

Afrim Oruqi – Në pyetjen e zt. Eqrem Spahiu për parcelën në fjalë: Është kusht sipas legjislacionit në fuqi që qasja Zonës Ekonomike t’i krijohet në rrugë kryesore dhe jo dytësore. Projekti është publik dhe kjo është zgjidhja e vetme. Burim, projekti punohet brenda këtyre dy parcelave, me vendime jemi me kohë dhe obligative e kemi të qasemi në atë anë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! Atëherë nëse edhe dikush nuk ka ndonjë gjë për të thënë, po e vendosim në votim! Kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet edhe pika e dhjetë e rendit të ditës.

Vazhdojmë me pikën e njëmbëdhjetë: Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-00050-0, ZK Opterushë, a ka dikush prej anëtarëve të kuvendit diçka për të thënë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e dymbëdhjetë: Shqyrtimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01015-12, ZK-Xërxe, a ka dikush prej anëtarëve të kuvendit diçka për të thënë rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”?... Me shumicë votash miratohet pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës. Vazhdojmë me pikën e trembëdhjetë: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për shpallje me interes të përgjithshëm publik P-01313-3, ZK-Rahovec.

Burim Krasniqi – Meqenëse kjo po bëhet për krijimin e mundësisë për ndërtimin e sheshit, është edhe një pjesë si rrugë prapa saj rreth 2.5m, a është pronë publike apo private?

Afrim Oruqi – Po i nderuar është një parcelë tjetër, është pronë publike, mirëpo kësaj parcele në vitin 2023 sipas bordit të drejtorëve iu ka dhënë servituti dhe është ndarë në gjerësi prej 4m dhe pronarët e kanë gëzuar të drejtën e kalimit në formë rruge të dalin në pjesën tjetër në drejtim të qytetit. Në çoftëse arrihet ky qëllim, do të provojmë ta kthejmë parcelën me parcelizim. Me pronarë jemi në rrugë të mbarë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor! A ka edhe dikush diçka rreth kësaj çështje? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është “për”? Me shumicë votash miratohet edhe pika e trembëdhjetë.

14. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimvendimit për shfuqizimin e vendimit 01 Nr.63/23, i datës 28.4.2023, për vënien në mbrojtje të “Kanionit të Drinit të Bardhë”;

Burim Krasniqi – Kryesues, po ju drejtohem juve! Në çoftëse vjen sërish kjo kërkesë e Kanionit, ju lutem të vie me hartë të zonës aktuale dhe jo vetëm ta kemi propozimin se sa do të jetë zona e mbrojtur, por të jetë me hartë dhe ta bëjmë një krahasim mes gjendjes aktuale dhe asaj që kalon me rastin e marrjes së vendimit.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues! Bashkë me ministrinë e Mjedisit e kemi bërë vendimin për Kanionin “Drini i Bardhë”, e kemi pasur edhe një takim me ta. Për shkak të personelit të vogël, ata na kanë kërkuar falje për këtë gjë, u ka ikur një arsyeshmëri që është bërë në 2007, që sipas ligjit kjo arsyeshmëri i ka vlerë vetëm 2 vjet dhe këtë e ka bërë një komision i ministrisë së Mjedisit, këta nuk e kanë vërejtur për shkak të numrit të madh të lëndëve në gjithë Kosovën. Ne duhet ta fillojmë procedurën prej fillimit, pas shfuqizimit.

Burim Krasniqi – Në seancë na ke thënë që duhet ta votojmë propozimin ashtu siç e keni, ndryshe nuk bon sepse MAPL na kthen pas. Kur i krahasojmë hartat, hartën e rekomandimit të komisionit dhe hartën që është votuar këtu, dallojnë në mes vete dhe ka mospërputhje.

Lirigzon Kastrati – Faleminderit kryesues! Nuk po arrij të kuptoj atë që po thotë drejtori. Në arsyeshmëri të vendimit, pika 2 thotë: Që Komuna e Rahovecit nuk ka kërkuar paraprakisht të marrë pëlqim nga Ministria e Mjedisit Planifikimit Hapësinor dhe Infstrukturës sipas nenit dhe ligjit në fuqi. Ju thoni që jeni takuar me zyrtaren, por a i keni dorëzuar kërkesë zyrtare për marrjen e pëlqimit.

Afrim Oruqi – Në pyetjen e zt. Burim Krasniqi, secili prej kuvendarëve e ka materialin e komisionit profesional të themeluar me vendim të ministrisë i cili ka propozuar saktë edhe një hartë se cilat parcela që ata kanë menduar që të vazhdojnë të jenë në zonë të mbrojtur të Kanionit. Komisioni dhe ministria na ka thënë që, hartën bazë e keni, krijoni një hartë tjetër dhe mos dilni prej kësaj harte sepse përndryshe vendimi nuk kalon. Kurdo që është nevoja i vendosim dy propozimet në projektor edhe propozimin e ministrisë edhe propozimin që e keni ju. I nderuar Lirigzon, zonja në arsyeshmëri të vendimit se pse është i kundërligjshëm, nuk mund të thotë që jemi “pak” se nuk ka pasur guxim, kanë qenë pesë zyrtarë, e tani është vetëm një.

Kryesuesi – Nëse edhe dikush nuk ka diçka për të thënë, po e vendosim në votim, kush është “për” shfuqizimin e këtij vendimi? Me shumicë unanim miratohet shfuqizimi i vendimit, respektivisht pika e katërbëdhjetë.

15. Shqyrtimi i Raportit të komisionit për zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe të lagjeve urbane;

Nora Boshnjaku - Faleminderit kryesues! I nderuar kryetar, të nderuar kuvendarë. Para vetes e keni një raport me procesverbal për zgjedhjen e kryetarëve të fshatrave dhe lagjeve urbane. Në raport i keni të gjitha informacionet bazike, komisioni e ka kryer punën konform rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e komunës me fshatra dhe lagje urbane. Komisioni ka qenë i përbërë prej 7 anëtarëve: Melinda Oruqi – Iska, Faton Ramadani, Afrim Berisha, Leonard Morina, Vjollca Gurgule, përfaqësuesi i fshatrave dhe unë, Nora Boshnjaku. Janë zgjedhur 29 kryetarë të këshillave lokal dhe na kanë mbetur edhe disa lokacione, për arsye të mos shprehjes së interesimit. Faleminderoj anëtarët e komisionit për punë dhe gatishmëri.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues! Fillimisht i falënderoj anëtarët e komisionit për punën që e kanë kryer në zgjedhjen e këshillave të fshatrave dhe lagjeve. E kam lexuar me vëmendje raportin dhe e kam vërejtur që ndër të tjera, në shumë fshatra ku janë zgjedhur këshillat, nuk janë emrat e anëtarëve të këshillit, kështuqë, raporti ende nuk është i kompletuar dhe unë i quaj zgjedhje jo të rregullta këto, në bazë të rregullores që e kemi miratuar në kuvend.

Bëhet fjalë më së paku për dhjetë fshatra që nuk figutojnë emrat e këshillit të fshatit. Kjo punë është e përfunduar, po fajin e kanë anëtarët e komisionit sepse kryetari i komisionit duhet të jetë nga radhët e anëtarëve të kuvendit dhe jo nga ekzekutivi. Nuk më pengon që ka qenë Nora, por i referohem rregullores.

Nora Boshnjaku – I nderuar zt. Rasim Fazliu, nëse nuk gaboju në mandatin e kaluar edhe ju keni qenë pjesë e komisionit. Unë e ceka, komisioni punën nuk e ka përfunduar ende, raportin e kemi vendosur në kuvend karshi transparencës ndaj jush sepse jemi të obliguar ligjërisht për raportim. Ideja ka qenë kështu, në shumicën e lokaliteteve kryetarët e zgjedhur bashkë me të tjerët nuk kanë arritur ndoshta ta gjejnë një emër të përbashkët për shkak të lagjeve dhe mospjesëmarrjes. Kemi lënë hapësira të mjaftueshme që në vazhdim ata t'i vendosim emrat. Pa marrë parasysh se kush është pjesë e komisionit, puna në terren ka qenë shumë e vështirë.

Rasim Fazliu – Fillimisht ju falënderova juve dhe komisionin në tërësi. Sa për dijeni edhe unë kam qenë pjesë e komisionit qysh herën e parë kur kemi pasur bashkëpunim për reforma me DEMOS-in. Nuk kanë lejuar që në një lokacion ta zgjedhim kryetarin dhe më pas të vijnë emrat e këshillit. Procedura përfundonte aty për aty. Vetëm desha t'ju them që në punën që e keni përfunduar, ka lëshime.

Burim Krasniqi – Pajtohem me Rasimin në parim. Por është një e mirë përsëri që komisioni nuk ka fsheh asgjë në raport, por e ka paraqitur realitetin e terrenit. Konsideroj që secili prej neve në lokalitetet prej nga vijmë, ta ndihmojmë komisionin t'i kompletonte këshillat e fshatrave dhe lagjeve sepse është komisioni i zgjedhur nga ne dhe duhet ta mbështesim.

Lirigzon Kastrati – Sa e di unë, ky komision është paguar nga kuvendi dhe i kanë kry pagesat. Drejtoreshë, pse po shqetësohesh që the ta formojmë një komision tjetër! Ne jemi anëtarë të kuvendit dhe kemi të drejtë të kërkojmë plotësime dhe ndryshime. Te komisioni, pajtohem me bacën Rasim.

Kryesuesi – E kam përcellur punën e komisionit dhe e kanë bërë një punë të mirë. Te çështja e kryetares së komisionit, Nora ndoshta është zgjedhur edhe për çështje administrative dhe varësisht prej punës, ka qenë një punë voluminoze për një periudhë shumë të shkurtër. Hapësirat mund t'i përmirësojmë edhe në vazhdim.

Kryetari – Së pari e falënderoj komisionin dhe posaçërisht Norën. Me rregullore (neni 3), anëtarët e komisionit e përcaktojnë kryesuesin. Burimi e tha shumë mirë që duhet të mobilizohemi çdo kush prej lokaliteteve prej nga vijmë, në mënyrë që t'i përfundojmë të gjitha fshatrat e mbetura (Krushë e Madhe, Hoçë e Vogël, Kaznik) dhe një lagje në qytet. Nora është e vetmja që nuk është paguar, e ka marrur përsipër t'i kryej punët administrative dhe në fund me ligj nuk i takon pagesa.

Kryesuesi – Atëherë po e përmbyllim pikën e pesëmbëdhjetë të rendit të ditës.

16. Shqyrtimi i informatës nga Drejtoria për Shërbime Publike;

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues, përshëndetje kryetar. Në mungesë të zyrtares për mjedis, do të raportoj për të. Ju njoftoj që nga "Granti për Mjedis të Pastër", komuna jonë ka fituar dy kamionë për mbledhjen e mbeturinave dhe kontejnerë. Shpresojmë që ta marrim edhe një pajisje tjetër. Në fund, falënderoj organizatën "JICA" për mbështetje dhe jemi një ndër komunat e para në Kosovë që do t'i trajtojmë mbeturinat e vëllimshme.

Lirigzon Kastrati – Prej drejtorit kërkoj që në seancën e radhës ta kemi një raport për mjedisin e Komunës së Rahovecit. Raporti i tillë do të ishte më i qëlluar sesa kjo informatë.

Kryetari – E drejtë e juaja Lirigzon është që të keni kërkesa legjitime të tilla, por ne i përmbahemi Planit të Punës së Kuvendit.

Ilir Pallqa – Faleminderit kryesues! E kemi lexuar informatën dhe është fol kryesisht për sfida. Gjendja e mbeturinave dhe ruajtja e mjedisit është sfida. Komuna është për t'u përballur me këto sfida, kuptohet që përgjegjës janë edhe banorët dhe duhet të ketë një bashkëpunim dhe mirëkuptim në mes banorëve dhe institucioneve. Nisjen drejt këtij bashkëpunimi duhet ta bëjnë institucionet. Nisja mund të bëhet edhe me DKA-në, ku mund të përcaktojmë orë stimuluese - atraktive për nxënësit me profesorë kompetent, që të përhapet sa më shumë mesazhi për ruajtjen e ambientit. Mund të bëhet me postime dhe bilborde kreative, por fillimisht duhet të ketë shporta. Në rrugët kryesore

nuk kemi shporta të vogla ose janë shumë të rralla. Para disa viteve kishte më shumë, d.m.th nuk po përparojmë, as nuk po ngelim, por jemi prapa. Komuna në një mënyrë po i orienton banorët që t'i hedhin mbeturinat në rrugë! Ndoshta e ka për qëllim të krijojë huti për banorët, pra të përzihen mbeturinat me “bërlllogun qeverisës” që po ndodh në komunë këto kohë. Te deponitë përballë shtegut të ecjes së “Majës së Shkodranit” është një tabelë ku ndalohet huthja e mbeturinave, hudhen mbeturinat dhe nuk ndërmerri asgjë. Qeverisja është sfiduese, por me pak punë dhe mirëkuptim mund të arrihet që komuna jonë të jetë shembull për pastërti dhe fillimisht duhet që ekzekutivi të jetë i “pastër”.

Kryetari – Unë e di që je djalë i ri dhe ende ke kohë për maturim, gjithashtu e di që mund të flasësh tërë ditën dhe mos të thuash asgjë! Vlerësimet se çfarë niveli të pastërtisë kemi ne si qeveri dhe unë si kryetar i komunës, nuk i bënë ti, por i bëjnë qytetarët e Komunës së Rahovecit dhe organitatat që merren me vlerësime dhe anketime. Jam shumë i kënaqur që ende nuk i di se ku gjenden zyrat e hetuesisë, ndërsa shumë prej jush i dini shumë mirë këto zyra, jo për çështje të qeverisë, se ju në qeveri e keni problemtë vini, por për çështje tjera. Ne e kemi sfidë të madhe çështjen e mjedisit dhe mbeturinave, por mund të ju them që më shumë ka pasur mbeturina dje sesa sot dhe më pak mbeturina do të ketë nesër sesa që ka sot. Në mandatin e parë më kujtohet që askund nuk janë menaxhuar mbeturinat, përveç në rrugën kryesore të qytetit dhe në Hoçë të Madhe (2003-2006), ndërsa sot po flasim për deponi ilegale që krijohen nga elementi i papërgjegjshëm i cili e ka deponinë legale dhe hedhë mbeturina në vend joadekuat. Ne i kemi rritur kapacitetet edhe të inspektoriatit, kontrolli vazhdon duke u rritur çdo ditë dhe po bëhet sistematik. Nuk e kemi problemin e hedhjes së mbeturinave për shkak të mungesës së kontejnerëve, përkundrazi, ka kontejnerë të mjaftueshëm dhe vende të adresuara se ku duhet hedhur mbeturinat. Nuk mund ta pranojmë logjikën e “kontrabandës politike” në fjalor që e merr guximin të thotë që qeveria e komunës i orienton qytetarët t'i hedhin mbeturinat në rrugë, ashtu siç është higjiena këtu e keqe. Është hera e fundit që Ilir Pallqa kualifikon, përndryshe ka ardhur koha që dikush ta bëjë një kallëzim penal për poshtërsitë që i shpreh me indinjatë dhe urrejtje. Për këto çështje mund të përgjigjesh para organeve të tjara dhe në seancat tjara do ta lus kryesuesin që të të penalizojë nëse vazhdon me këtë fjalor banal dhe të poshtër. Politikë nuk është kjo, politika e ka një fije moral dhe shumë parime.

Ilir Pallqa – Para se të jem këtu, kam qenë kandidat për asamble. Unë funksionoj brenda rregullores së kuvendit dhe brenda Ligjit për vetqeverisje lokale.

Kryesuesi – Atëherë po e mbyllim këtë seancë, faleminderit për pjesëmarrje, shihemi në mbledhjet e radhës.

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.104/23

Me datë:31.7.2023

Procesmbajtësi:

Albion Krasniqi

Kryesuesi i Kuvendit

Arbër Zenuni



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic Of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec / Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

Drejtoria e Shëndetësisë dhe Përkujdesje Sociale
Odeljenje za Zdravstvo i Socijalnu Zaštitu
Department of Health and Social Welfare

Datë/Datum/Date:	07.07.2023
Referenc-ë	
Për/Za/To:	Sekretarin e kuvendit komunal Rahovec
Përmes/Preko/Through:	
Nga/Od/From:	Znj.Saranda Sallteku, Drejtoreshë e DSHPS-së Rahovec
Subjekti/Predmet/Subject:	Informat në Shëndetësi Janar- Qershor 2023

I nderuar,

Drejtoria për shëndetësi dhe mirëqenie sociale ka dy sektor:

1.sektori për shëndetësi

2.sektori për mirëqenie sociale

Aktivitetet e drejtorisë së DSHPS-së, gjatë gjashtë muorit të parë të vitit 2023 janë fokusuar kryesisht në ofrim të shërbimeve mjekësore për qytetarët e komunës së Rahovecit, për përmasimin e kushteve të punës punonjësve shëndetësorë.

Gjatë periudhe Janar – Qershor 2023 jane kryer gjithsej 55117 shërbime prej tyre

2160 raste Urgjente të trajtuara në sektorin e urgjencës

34061 terapi intramuskulare

2995 infuzione

2622 shërbime në laborator

1835 shërbime në Rtg

183 mamografi

1552 shërbime gjinekologjike

319 vizita shtepiake

250 vizita shtepiake per nena dhe femije 0-3 vjec

Në periudhën janar qershor janë kryer 13 lindje në QKMF.

Per kete 6 mujor QKMF ‘Dr. Fahredin Hoti’ ka kryer keto aktivitetet:

Akreditohet programi i EVP per mjek dhe infermiere per vitin 2023.

Ne bashkepunim me Ministrine e Shendetesise kemi organizuar Karvanin e Vaksinimit aktivitet gjate te cilit kemi vaksinuar persona me vaksina anticovid dhe kunder gripit sezonal.

Fale vizitave shtepiake per nena dhe femije kemi fituar grant nga UNICEF-i nje veture te re per nevojat e QKMF-se.

Ne kete periudhe kemi funksionalizuar Sektorin e Urgjences ne QKMF me orar pune 24 ore 7 dite te javes me 4 ekipe te perbere nga 1 mjek dhe 2 infermiere. Ne te njejtin muaj fillon edhe kursi i trajnimit per Urgjence i infermiereve ku do te zgjase 5 muaj gjate te cilit do te trajnohen 50 infermiere.

Nga muaji maj kemi funksionalizuar sektorin e mjekesise familjare edhe te dielave me orar 07:00-21:00 ne kete periudhe janë kryer vizitat sistematike te nxanseve ne shkollat e komunës se Rahovecit,po ashtu kemi organizuar JAVEN E SHERBIMEVE SHENDETESORE FALAS NE KOMUNITET ku gjate gjithë javes jane kryer sherbime mjekesore si matja e glikemise, tensionit arterial dhenja e keshillave mjekesore etj.

Ne bashkepunim me asociacion te komunave te Maqedonis Veriore kemi organizuar konferencën per managjim te pandemis ne kuadër te projektit te :SOLICO”projekt i bashkimit european per përvojat e managjimit te pandemis ne shtetet e Ballkanit Perendimor.

Eshte bere përrurimi i renovimit te objektit te vjetër te QKMF-se, ku janë permisuar kushtet per ofrim sa me cilsor te shërbimeve mjekesore.

Eshte ne përfundim e sipër ndërtimi i objektit te ri AMF-se, ne lagjen e epërme ku shume shpejt dote përfundoj objekti, ku dote marin shërbime pjesa dërmuese e qytetit.

Jane bler edhe dy autoambulanca te emergjencës per nevojat e QKMF-se.



Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Uprava za Poleprivredu, Sumarstvo i Ruralni Razvoj

Department of Agriculture, Forestry and Rural Development



Informatë

Janar-Qershor 2023



Përmbajtja

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL.....	3
Aktivitete në periudhën: Janar, Shkurt, Mars.....	3
Aktivitete në periudhën: Prill, Maj, Qershor	5
Subvencionet 2023.....	5
Shpërndarja e paisjeve bujqësore.....	7
Projektet e investimeve kapitale.....	7
Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore:.....	7
Kanalet e kullimit.....	7
Pastrimi i përrenjëve	8
PËRFUNDIM.....	8

DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL

Bujqësia, Pylltaria dhe Zhvillimi Rural janë sektorët kryesor të cilët mund të kontribuojnë dukshëm në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit.

Komuna e Rahovecit përmes politikave dhe strategjive zhvillimore është orientuar në mbështetje të faktorëve të prodhimit, në stimulimin e fermerëve dhe në krijimin e një ambienti sa më të favorshëm zhvillimor. Këto politika dhe strategji janë duke krijuar mundësi që të arrihet një zhvillim i qëndrueshëm dhe një shfrytëzim shumë më efikas i resurseve natyrore të cilat i posedon komuna jonë.

Fillimi i vitit është karakterizuar me përpilimin e planit të punës për vitin 2023, plani i hartuar është mjaft ambicioz i cili ka ngërthyer në vete aktivitete të shumta në kuadër të drejtorisë së bujqësisë. Në kuadër të këtij plani është bërë edhe planifikimi i aktiviteteve, i ndarë në periudha tremujore.

Aktivitetet në periudhën: Janar, Shkurt, Mars

Në kuadër të drejtorisë së BPZHR-së, nga janari janë realizuar një mori aktivitete.

Aktivitetet të cilat kryhen vazhdimisht siq janë pranimi dhe përgjigje ndaj kërkesave të ndryshme nga qytetarët, si dhe shërbime të tjera në kuadër të drejtorisë si: vërtetim për fermer që dëshmon se janë prodhues bujqësorë, NIF, ndërrim i destinimit të tokës bujqësore, vlerësim të dëmeve të shkaktuara në sektorin e bujqësisë, si dhe barazimi mujor i të hyrave me Drejtorinë e Financave për muajt Janar, Shkurt dhe Mars etj.

Ndërsa aktivitetet më kryesore paraqiten të specifikuara sipas kohës në të cilën kanë ndodhur.

Ashtu siç e kemi paraparë me planin vjetor të punës, pranimi i aplikacioneve për subvencionim të qumështit për gjashtëmujorin e dytë të vitit 2022 për fermerët blegtor (MBPZHR), hap thirrjen për aplikim, Drejtoria e BPZHR-së pranon aplikacionet dhe të njëjtat i dorëzon në Ministri për pagesë. Kjo thirrje ka qenë e hapur nga: **12 janar deri më 10 shkurt 2023**.

Gjithësej kanë aplikuar **81** blegtorë, prej të cilëve:

73 blegtorë kanë qenë aplikues vetëm për qumësht/litër sipas kategorive të cilësisë, me rreth **1.862.692** litra

Ndërsa **16** prej tyre kanë aplikuar edhe për viqa për majmëri, gjithësej për **278** krerë.



Është bërë pritja e fermerëve në mënyrë individuale apo edhe grupore duke iu dhënë informata lidhur me procesin e kompensimit të dëmeve.

Gjatë muajit janar për shkak të sasisë së lartë të reshjeve, kanë ndodhur disa vërshime në tokat bujqësore si pasojë e prurjeve të mëdha të ujit dhe daljes nga shtrati të lumit Drini i Bardh, kemi pranuar informata nga disa fermerë që iu janë shkaktuar dëme dhe të cilëve më pas iu kemi pranuar kërkesat e tyre dhe është përpiluar raporti.

Kemi pranuar nga MBPZHR-ja listat e fermerëve të dëmtuar nga vërshimet dhe breshëri gjatë vitit 2022, për të cilët ne kemi dërguar dy ankesa, të cilëve ju është aprovuar ankesa, dhe atyre që janë refuzuar.

Ankesa ju është aprovuar gjithsej **243** fermerëve ne vlerë rreth **1,060,000€**

Ndërsa të refuzuar gjithsej **83** fermerëve në vlerë rreth **254,000€**

Kemi përgatitur një ankesë tjetër dhe e kemi dërguar në MBPZHR për fermerët që janë refuzuar të cilët gjithsej janë **83** fermerë në vlerë rreth **254,000€**, ankesën e kemi dërguar për fermerët të cilët kanë siguruar dëshmi dhe janë paraqitur në zyrat e DBPZHR-së, mirëpo përmes një emaili nga MBPZHR-ja jemi njoftuar se ankesën që e kemi dërguar për 83 fermerët është refuzuar. Listën me emrat e këtyre fermerëve dhe të dhënat tjera i kemi përcjell te organizata FAO ku kemi kërkuar që të kompensohen fermerët e dëmtuar gjatë muajit janar nga dalja e shtratit të lumit Drini i Bardhë si dhe nga erërat e forta, dhe për fermerët e refuzuar nga Komisioni në kuadër të Ministrisë.

Është bërë shpallja e ankandit publik për dhënien e tokës bujqësore komunale me qira, gjithsej 8 për herë të parë dhe 2 të rishpallura. Janë hapur ofertat dhe janë lidhur kontratat me përfituesit e përzgjedhur nga komisioni.

Me **8 mars 2023**, në sallën e kuvendit në bashkëpunim me MBPZHR-në dhe IFC-ën është mbajtur sesion Informues lidhur me Sigurimet Bujqësore, janë informuar bujqit për produktet që mund ti sigurojnë nga fatkeqësitë natyrore. Në këtë takim komuna e Rahovecit, mori përsipër të mbulojë 15% të primit të sigurimit të produkteve bujqësore.

Vaksinimi nga veterinari ka filluar në muajin shkurt por ka vazhduar edhe gjatë muajit mars, gjithsej janë vaksinuar rreth **1940** krerë.



Aktivitetet në periudhën: Prill, Maj, Qershor

Ka filluar të zbatohet kontrata “ Trajtim i Qenëve Endacak”

Organizata “Syri i Vizionit” në bashkëpunim me DBPZHR dhe DEZHT ka mbajtur sesion informues me **03 Maj 2023** (e mërkurë) në salla e Kuvendit Komunal – Rahovec, prej 10:00 deri në 12:00. Ky sesion u mbajt në kuadër të projektit "Gratë dhe personat me aftësi të kufizuara si ndërmarrëse bujqësore në Kosovë" të financuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim (ADA) me fondet e Bashkëpunimit Austriak për Zhvillim dhe bashkëfinancuar nga “Brot für die Welt”

Është mbajtur edhe një takim më datën **4 Maj 2023**, në ora 13:00 në Sallën e Kuvendit Komunal, për fermerët të cilët kanë shprehur gatishmërinë për sigurimin e kulturave bujqësore në kompanitë e sigurimit për: vreshat, grurë, misër, fasule, patate etj. Komuna e Rahovecit, ashtu sikurse vitin e kaluar, do të mbulon 15% të vlerës ndërsa 75% e ka marrur përsipër Ministria e Bujqësisë. Edhe përkundër informimit interesimi i fermerëve ishte shumë i vogël për pjesëmarrje.

Subvencionet 2023

Aplikimi për subvencionet ne sipërfaqe ka filluar me datë **17.03.2023** dhe ka mbaruar me datë **14.04.2023**.

Ne si drejtori e BPZHR-së jemi angazhuar të mobilizohemi me zyret në Krushë të Madhe dhe Ratkoc ashtu sikurse edhe vitet e kaluara që fermerët e disa vendbanimeve të mos krijojnë fluks të madh në zyrat e DBPZHR-së në Rahovec, por aplikimin të kenë mundësi ta kryejnë edhe në këto dy qendra të mëdha poashtu kemi bërë kërkesë për hapjen e userave për zyrtarët të cilët kanë pranuar aplikacione të bujqëve.

Numri total i fermerëve që kanë aplikuar për vitin 2023 është **3,119** ku krahasuar me vitin 2022 kemi **141** aplikacione më shumë.

Pas përfundimit të procesit të aplikimit, zyrtarët e angazhuar e kanë bërë kontrollimin e secilës dosje dhe të njejtat janë dorëzuar në AZHB (Agjencioni për Zhvillimin e Bujqësisë).

Sikurse në vitet e kaluara pas përfundimit të procesit dhe dorëzimit të aplikacioneve në AZHB, në kuadër të drejtorisë së Bujqësisë bëhet regjistrimi i të dhënave të fermerëve që kanë aplikuar për secilën kulturë bujqësore. Këto të dhëna më pastaj përlllogariten, analizohen dhe krahasohen me vitet paraprake.

Në tabelat dhe grafikonet më poshtë janë paraqitur të dhënat sipas sektorëve të shprehura në sipërfaqe (ha) si dhe në vlera monetare (€) që nënkupton se komuna e Rahovecit do të përfitoj mbi **5,7** milion euro në vitin 2023, rreth **270,818 €** më shumë se në vitin 2022.

Tabela 1. Të dhënat sipas aplikacioneve të fermerëve dhe diferenca mes vitit 2022/2023 të shprehura në Siperfaqe

VITET			2022	2023
Sektorët	Lloji	Nj. Matëse	Sip ose Nr.	Sip ose Nr.
Sektori i Lavertarise	Dritherat	ha	3,711.24	4,768.34
	Grurë - KG	kg	0.00	0.00
Sektori i Vreshtarisë	Rrush	ha	2,322.21	2,274.57
	Verë	Litër	7,274,876.45	7,654,411.00
	Fidane të hardhisë	copë	149,900.00	
Sektori i Perimkulturës	Perime	ha	1,213.94	1,114.97
	Kungullore	ha	579.58	423.16
Sektori i Pemtariisë		ha	165.23	194.31
Sektori i Blegtorisë dhe shpezëtarisë	Bletë	koshere	4,245.00	4,793.00
	Lopë	krerë	1,938.00	1,953.00
	Dhi	krerë	248.00	167.00
	Dele	krerë	7,226.00	7,396.00
	Pula vojëse	copë	59,100.00	60,260.00
Bimë Mjekësore dhe Aromatike - BMA			16.51	8.54
Perime ne Serra	Te ndryshme	ha	24.26	27.21

Tabela 3. Të dhënat sipas aplikacioneve të fermerëve dhe diferenca mes vitit 2022/2023 të shprehura në EURO

VITET		2022	2023	Diferenca
Sektorët		Vlera në €	Vlera në €	Vlera në €
Sektori i Lavërtarisë	Dritherat	1,255,391.96 €	1,627,232.86 €	371,840.90 €
	Grurë - KG	0.00 €		0.00 €
Sektori i Vreshtarisë	Rrush	2,447,609.34 €	2,397,396.78 €	-50,212.56 €
	Verë	290,995.06 €	290,995.06 €	0.00 €
	Fidane të hardhisë	22,485.00 €	18,600.00 €	-3,885.00 €
Sektori i Perimkulturës	Perime	689,203.76 €	636,805.38 €	-52,398.38 €
	Kungullore	210,956.32 €	175,984.14 €	-34,972.18 €
Sektori i Pemtariisë		74,353.50 €	97,932.24 €	23,578.74 €
Sektori i Blegtorisë dhe shpezëtarisë	Bletë	84,900.00 €	95,860.00 €	10,960.00 €
	Lopë	174,420.00 €	175,770.00 €	1,350.00 €
	Dhi	6,200.00 €	4,175.00 €	-2,025.00 €
	Dele	180,650.00 €	184,900.00 €	4,250.00 €
	Pula vojëse	27,339.66 €	30,130.00 €	2,790.34 €
Bimë Mjekësore dhe Aromatike - BMA		7,429.50 €	4,304.16 €	-3,125.34 €
Perime ne Serra		21,931.04 €	24,597.84 €	2,666.80 €
Gjithsej		5,493,865.14 €	5,764,683.46 €	270,818.32 €

Shpërndarja e paisjeve bujqësore

Më **28.04.2023** është bërë shpërndarja e **42** pllugjeve 5 brazëshe

Më **06.06.2023** është bërë shpërndarja e **149** motokultivatorëve dhe **5** pllugjëve 5 brazësh



Projektet e investimeve kapitale

Rregullimi dhe mirëmbajtja e rrugëve fushore:

Lot 1 – Kane filluar punimet në Krushë të Madhe në segmentin Vija e Rrasës që i lidhë rrugët Udhë Bjeshke dhe Udhë Perove. Poashtu punimet janë duke vazhduar në rrugën “Udhë Nalli”

Lot 2- Pas përmirësimit të kushteve atmosferike kanë rifilluar punimet, aktualisht është duke u punuar në fshati fshatin Guri i Kuq, konkretisht në rrugën që lidh dy vendbanime Gur i Kuq-Polluzhë.

Lot 3. Punimet po kryhen në qytetin e Rahovecit, konkretisht në vendin e quajtur Sejan, janë duke u rregulluar rrugët vreshtarë

Lot 4. Ka vazhduar mirëmbajtja nëpër lokacione të ndryshme si në përmirësimin e rrugëve poashtu edhe në vendosjen e lëshesave sipas kërkesave të fermerëve të komunës sonë.

Kanalet e kullimit

Kanali i Kullimit në Ratkoc – Gjatë kësaj periudhe Operatori Ekonomik që ka kontratë me komunën tonë ka rifilluar punimet në ndërtimin e këtij kanali. Si rezultat i kushteve jo të mira atmosferike punimet nuk janë zhvilluar me intensitet të lart, dhe në disa raste edhe janë ndërprerë për shkak të prurjeve të mëdha të ujërave në këtë pjesë

Kanali i Kullimit nga Shtavica deri ne Fortese- Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e kanalit prej betoni nga Fortesa në drejtim të Rahovecit, aktualisht është duke u ndërtuar ura e cila do të iu shërbejë fermerëve për qasje më të lehtë

Kanali i Kullimit ne Qifllak- kanë rifilluar punimet, fillimisht në gërmim dhe hapje të kanalit përgjatë hekurudhës do të bëhet riparimi në segmentin e ndërtuar në vjeshtën e vitit të kaluar dhe më pastaj do të vazhdoj betonimi i segmentit te ri deri në lumin Drini i Bardh.

Kanali i Kullimit Fortesë – Celinë – ka përfunduar edhe segmenti i dyte i kanalit të drenazhës me fi: 160. Aktualisht është duke u punuar në segmentin 3 poashtu ne vendosjen e gypëve të drenazhës fi: 160 dhe do të filloi ndërtimi i kanalit kryesor me gypa fi: 1000 nga betoni.

Pastrimi i përrenjëve

Si rezultat i reshjeve të vazhdueshme dhe vërshimeve që na janë shfaqur viteve të fundit kemi lidhur kontratë për pastrimin e përrenjëve në tërë territorin e komunës sonë. Punimet janë zhvilluar në zonat më të ndjeshme dhe që janë më të rrezikuara në Fortesë, Celinë, Krushë e Madhe, Ratkoc, Vrajakë etj.

Është punuar në hapjen dhe pastrimi i përroit “ Bellaja” , nga hekurudha deri në magjistrale Prizren-Gjakovë dhe kanë vazhduar deri te lumi Drini i Bardhë me gjatësi rreth 3 km, kanë përfunduar punimet në përroit e fshatit Celinë me gjatësi 1.1 km, është punuar edhe në pastrimin e përroit nga Ratkoci në drejtim të fshatit Vrajakë me gjatësi 850 m.

PËRFUNDIM

Ky raport përmbledhës paraqet thekset kryesore të aktiviteteve që kanë ndodhur gjatë kësaj periudhe raportuese.

Kontakti me qytetarët dhe me grupet e interesit për të trajtuar dhe zgjidhur së bashku kërkesa, nevoja dhe interesa të tyre, është i vazhdueshëm. Zyrtarët e DBPZHR-së vazhdimisht janë në terren duke takuar fermerë në sektor të ndryshëm dhe duke iu ofruar këshilla të nevojshme rreth aktiviteteve agroteknike nëpër fermat e tyre.

Zyrtarët kanë qenë të gatshëm për çdo vlerësim dëmi me të cilët fermerët e komunës sonë ballafaqohen, ata dalin në terren në qdo fatkeqësi natyrore që ndodh dhe dëmton kulturat bujqësore.

Kemi krijuar raporte të mira me OJQ-të, me grupe të ndryshme, profesionistë të fushave, me theks të veçantë inxhiner të bujqësisë ku kemi pranuar këshilla, vërejtje dhe ide në mënyrë që të përmirësohemi dhe të zhvillojmë bujqësinë përditë e më mirë.

07.07.2023

DREJTORI I DBPZHR-së

Rahovec

Berat Duraku



Komuna e Rahovecit
Departamenti i Prokurimit

Për:	z. Smajl Latifi	Kryetari i Komunës së Rahovecit
Nga:	Astrit Mullabazi	Menaxher i Prokurimit në Komunën e Rahovecit
Lënda	Raporti gjashtë mujorë i punës në Zyrën e Prokurimit për vitin 2023	
Datë	06.07.2023	

Te nderuar!

Gjatë kësaj periudhe raportuese gjashtë mujore të punës nga Zyra e Prokurimit,

Ju njoftojmë se deri me tani kemi proceduar **45** Aktivitete të prokurimit;

Vlera e parashikuar e këtyre aktiviteteve është: **11,642,286.02 €**;

Deri më tani janë nënshkruar **24** Kontrata të gjitha prokurimeve: punë, furnizime, shërbime, ku

Vlera e kontratave të nënshkruar është: **1,102,170.88 €**;

Një (**1**) aktivitetet i prokurimit është në Ankesë;

Njëzetë (**20**) aktivitetet të prokurimit janë në procedura të prokurimit, sipas Ligjit të Prokurimit Publik;

Personeli i zyrës së prokurimit ka proceduar: **758 URDHËR BLERJE**, pagesa të ndryshme të Investimeve Kapitale, Mallra dhe Shërbime, vlera e të cilave është: **4,357,112.66 €**;



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly of Rahovec



Këshilli i fshatit Hoçë e Madhe

Raporti gjashtëmujor i punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe

Qershor 2023

Përmbajtja

Raporti gjashtëmujor i punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe	1
Hyrje:	3
Puna e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe:	4
Mbledhja e parë e rregullt për vitin 2023 është mbajtur me 05. Janar 2023, me këtë rend dite:	4
Mbledhja e dytë e rregullt është mbajtur 03. Shkurt 2023, me këtë rend dite:	4
Mbledhja e tretë rregullt është mbajtur me 03. Mars 2023, me këtë rend dite:	5
Mbledhja e katër e rregullt është mbajtur me 05. Prill 2023, me këtë rend dite:	5
Mbledhja e pestë e rregullt është mbajtur me 03. Maj 2023, me këtë rend dite:	6
Mbledhja e gjashtë e rregullt është mbajtur me 01. Dhjetorë 2022, me këtë rend dite:	6
Përfundimi:	7

Hyrje:

Këshilli për fshatin Hoçë e Madhe është këshill i cili themelohet nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-62 për fshatin Hoçë e Madhe si dhe Udhëzimin e Administrativë Nr. 11/2014 për themelimin, zgjedhjen, përgjegjësit dhe funksionimin e Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe.

Qëllimi i themelimit të Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe është në radhë të parë thellimi i bashkëpunimit të institucioneve lokale dhe atyre qendrore me qëllim të lehtësimit dhe ofrimit të mundësive sa më të mira në provimin e monumenteve kulturore, fetare, brenda zonës së veçant të mbrojtur. Po ashtu qëllimi i miratimit të ligjit Nr. 04/L-62 është përcaktimi i rregullave për mbrojtjen, administrimin dhe zhvillimin bashkëkohor i fshatit Hoçë e Madhe.

Puna e këshillit të fshatit Hoçë e Madhe:

Pas themelimit dhe mbledhjes së parë konstituive, Këshilli i fshatit në krye me kryesuesin e Këshillit të fshatit organizon mbledhje me qëllim të shqyrtimit të kërkesave të anëtarëve të Këshillit apo të institucioneve dhe qytetarëve në fushën e planifikimit, mbrojtjes, promovimit të monumenteve historike e kulturore në zonën e veçantë të mbrojtur të fshatit Hoçë e Madhe.

Në periudhën kohore 05. Janar deri me 02. Qershor janë mbajtur gjithsej 6 mbledhje të rregullta.

Mbledhja e parë e rregullt për vitin 2023 është mbajtur me **05. Janar 2023**, me këtë rend dite:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Përpilimi i raportit vjetor të këshillit të fshatit Hoçë e Madhe,**
- 3. Të ndryshme.**

Këtë mbledhje e Kryesoi Kryesuesi i Kuvendit i cili fillimisht ju uroj mirëseardhje të gjithë anëtarëve dhe pas konstatimit të kuorimit vazhdoj me procesin e miratimit të rendit të ditës, i cili është aprovuar në mënyrë unanime.

Pas shqyrtimit të procesverbalit, i njëjti është votuar dhe miratuar pa vërejtje dhe në mënyrë unanime.

Sa përket raportit vjetor të punës së Këshillit të fshatit Hoçë e Madhe, të gjithë anëtarët e këshillit kontribuan në përpilimin dhe përfundimin e tij.

Ndërsa në pikën e fundit të rendit të ditës anëtarët nuk kanë pasur ndonjë kërkesë të veçantë.

Mbledhja e dytë e rregullt është mbajtur **03. Shkurt 2023**, me këtë rend dite:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Përpilimi i planit të punës për vitin 2023,**
- 3. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve,**
- 4. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore,**
- 5. Të ndryshme.**

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i mbledhjes, i cili konstatoj kuorumin, prezantoi dhe aprovoi rendin e ditës, më pastaj kaloi tek pika e parë e rendit të ditës e cila pas shqyrtimit e njëjta është miratuar unanimisht.

Lidhur me pikën e dytë të rendit të ditës të gjithë anëtarë dhanë kontributin e tyre në përpilimin e planit të punës së këshillit të fshatit Hoçë e Madhe për vitin 2023.

Në vazhdim, për dy pika të radhës, në adresë të këshillit të fshatit nuk kanë arritur ndonjë kërkesë, apo sugjerim drejtuar anëtarëve të këshillit apo ekzekutivit, ndërsa në pikën e fundit të rendit të ditës, nuk ka pasur komente shtesë.

Mbledhja e tretë rregullt është mbajtur me **03. Mars 2023**, me këtë rend dite:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve,**
- 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore,**
- 4. Të ndryshme.**

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i mbledhjes, i cili konstatoj kuorumin, prezantoi dhe aprovoi rendin e ditës, më pastaj kaloi tek pika e parë e rendit të ditës e cila pas shqyrtimit e njëjta është miratuar unanimisht.

Në vazhdim, për dy pika të radhës, në adresë të këshillit të fshatit nuk kanë arritur ndonjë kërkesë, apo sugjerim drejtuar anëtarëve të këshillit apo ekzekutivit, ndërsa në pikën e fundit të rendit të ditës, nuk ka pasur komente shtesë.

Mbledhja e katër e rregullt është mbajtur me **05. Prill 2023**, me këtë rend dite:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve,**
- 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore,**
- 4. Të ndryshme.**

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i mbledhjes, i cili konstatoj kuorumin, prezantoi dhe aprovoi rendin e ditës, më pastaj kaloi tek pika e parë e rendit të ditës e cila pas shqyrtimit e njëjta është miratuar unanimisht.

Në vazhdim, për dy pika të radhës, në adresë të këshillit të fshatit nuk kanë arritur ndonjë kërkesë, apo sugjerim drejtuar anëtarëve të këshillit apo ekzekutivit, ndërsa në pikën e fundit të rendit të ditës, nuk ka pasur komente shtesë.

Mbledhja e pestë e rregullt është mbajtur me **03. Maj 2023**, me këtë rend dite:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i informatave, kërkesave të drejtorive të caktuar ose qytetarëve,**
- 3. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore,**
- 4. Të ndryshme.**

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i mbledhjes, i cili konstatoj kuorumin, prezantoi dhe aprovoi rendin e ditës, më pastaj kaloi tek pika e parë e rendit të ditës e cila pas shqyrtimit e njëjta është miratuar unanimisht.

Në vazhdim, për dy pika të radhës, në adresë të këshillit të fshatit nuk kanë arritur ndonjë kërkesë, apo sugjerim drejtuar anëtarëve të këshillit apo ekzekutivit, ndërsa në pikën e fundit të rendit të ditës, nuk ka pasur komente shtesë.

Mbledhja e gjashtë e rregullt është mbajtur me **02. Qershor 2022**, me këtë rend dite:

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar,**
- 2. Shqyrtimi i qarkores së parë buxhetore për vitin 2024,**
- 3. Shqyrtimi i përgjigjes në kërkes për furnimzim me llaptopa,**
- 4. Përpilimi dhe dërgesa e kërkesave institucioneve lokale ose qendrore,**
- 5. Të ndryshme.**

Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i mbledhjes, i cili konstatoj kuorumin, prezantoi dhe aprovoi rendin e ditës, më pastaj kaloi tek pika e parë e rendit të ditës e cila pas shqyrtimit e njëjta është miratuar unanimisht.

Sa i përket qarkores buxhetore, anëtarë të pranishëm janë pajtuar që kontributin për këtë pikë të japin në mbledhjen e radhës marr parasysh rëndësinë dhe volumin e materialit.

Në vazhdim, për dy pika të radhës, në adresë të këshillit të fshatit nuk kanë arritur ndonjë kërkesë, apo sugjerim drejtuar anëtarëve të këshillit apo ekzekutivit.

Në pikën e fundit të rendit të ditës, anëtarët kanë kërkuar nga administratori i zyrës që në mbledhjen e radhës ti informojë për Planin e Konzervimit i cili do të diskutohet në takim me përfaqësuesit e OSBE-së.

Përfundimi:

Roli i Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe është promovimi, mbrojtja si dhe konservimi i monumenteve kulturore e fetare brenda zonë së veçantë të mbrojtur, e cila përkufizohet në Ligjin Nr. 03/L-039/2008 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura.

Në këtë drejtim ne si anëtarë të zgjedhur të Këshillit për fshatin Hoçë e Madhe shprehim gatishmëri dhe jemi të hapur për bashkëpunim me të gjithë institucione çofshin ato lokale apo ato qendrore, duke ofruar i të gjitha informatat dhe rekomandimet e nevojshme me qëllim promovimit të monumenteve kulturore historike e fetare si dhe zhvillim ekonomikë e turistik në nivel të komunës.

Në fund shfrytëzojmë rastin të falënderojmë të gjithë për kontributin, bashkëpunim dhe ndihmë e dhënë në realizimin e qëllimeve tona si Këshill.

Me respekt!

**Kryesuesi i Këshillit
për fshatin Hoçë e Madhe**

Bojan NAKALLAMIQ



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 1 dhe 2 shkronja d), nenit 17 shkronja c) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008*”), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17 paragrafi 1 dhe 2 i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.3 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.7.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 105/23, i datës 31.7.2023 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510011-00171-0.
2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. **Erhan Morina**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.2. **Afrim Oruqi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës
 - 2.3. **Afrim Berisha**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës -AAK
 - 2.4. **Faton Ramadani**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës - LDK
 - 2.5. **Nazmi Bellaqa**, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet të pronës së paluajtshme të komunës, janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktojë çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe të plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdoherë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.106/23
Datë:31.7.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja d), nenit 17, shkronja c) dhe nenit 40, të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 17 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, nenit 17, paragrafi 1 dhe 2, i Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, dhe nenit 2, nenit 10, paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 57, paragrafi 1, pika 1.3, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.7.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës

1. Me këtë vendim formohet komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, të pronës së paluajtshme të komunës, duke u bazuar në vendimin paraprak të Kuvendit të Komunës së Rahovecit 01 Nr. 107/23, i datës 31.7.2023 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës P-71510033-01036-2 dhe P-71510033-01033-2.
2. Komisioni, sipas pikës 1 të këtij vendimi, përbëhet prej 5 (pesë) anëtarëve, si në vijim:
 - 2.1. **Afrim Oruqi**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.2. **Berat Duraku**, përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës;
 - 2.3. **Lirigzon Kastrati**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës – LDK;
 - 2.4. **Sejfullah Sejfullahu**, përfaqësues nga Kuvendi i Komunës - PDK;
 - 2.5. **Adelina Paqarizi**, përfaqësues nga sektori joqeveritar.
3. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër deri në pesëmbëdhjetë (15) vjet, të pronës së paluajtshme të komunës, janë: shpallja e njoftimit publik për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, të përcaktojë çmimin fillestar, të caktojë kushtet dhe kriteret e ankandit publik etj.
4. Obligohet komisioni që të veprojë duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, si dhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës.

5. Obligohet Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të komunës, t'i zhvillojë procedurat e ankandit publik dhe vlerësimin e ofertave.
6. Administrata e Komunës i ofron përkrahje komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës.
7. Kuvendi i Komunës së Rahovecit e ruan të drejtën ekskluzive të ndryshimit dhe të plotësimit të anëtarëve të komisionit kurdoherë që kërkohet.
8. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen anëtarët e komisionit dhe Zyra e Prokurimit.
9. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komisionit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01Nr.108/23
Datë:31.7.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008*”), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.3.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.7.2023, merr këtë:

V E N D I M

Për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës 02 Nr. /958/23, i datës 6.7.2023 dhe merret vendimi paraprak për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
2. Prona e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, e cekur në pikën **1** të këtij vendimi, është në zonën kadastrale Vrajak, në vendin e quajtur arash-izbeg, me kulturë Kullosë e Klasës 3, e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë P-71510011-00171-0, në sipërfaqe prej 3500m² (tre mijë e pesëqind metra katror), e cila ndahet nga sipërfaqja e përgjithshme prej 4789m² (katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale, për zhvillimin dhe kultivimin e bujqësisë dhe të blegtorisë, si dhe dhënia e mundësisë qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Afati kohor për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej pesëmbëdhjetë (15) vjet.
5. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronar i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t’i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
6. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën **1** dhe **2** të këtij vendimi, mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës**, sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20, e datës 29.6.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.

7. Obligohen Drejtoria për Ekonomi, Zhvillim dhe Turizëm, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që, në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvillojë procedurat e ankandit publik, në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
8. Obligohet Kryetari i Komunës që, pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktojë me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe të përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
9. Procedura për dhënie e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
10. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose ueb – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.105/23
Me datë:31.7.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 2 shkronja (d), nenit 17 shkronja a) dhe nenit 40 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“*Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008*”), nenit 5, nenit 6 paragrafi 1 pika 1.1 dhe nenit 8 paragrafi 1 pika 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, nenit 5 paragrafi 1 pika 1.2, nenit 6, nenit 8 dhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 pika 2.4, nenit 40, nenit 57 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.7.2023 merr këtë:

V E N D I M
Për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër

1. **Miratohet** propozimi i Kryetarit të Komunës 02 Nr. 966/23 i datës 7.7.2023 dhe merret vendimit paraprak për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim personave fizik dhe juridik dhe zhvillimin e procedurave të ankandit publik për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër nga 1 (një) deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vite.
2. Pronat e paluajtshme për dhënie në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 të këtij vendimi janë:
 - 2.1. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01036-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur suga-kod puta, me kulturë Arë e Klasës 4, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2445m² (dy mijë e katërqind e dyzet e pesë metra katror), dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 1600m² (një mijë e gjashtëqind metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
 - 2.2. Parcela sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71510033-01033-2 në zonën kadastrale Xërxë, në vendin e quajtur Skaja, me kulturë Arë e Klasës 3, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2162m² (dy mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy metra katror), dhe në shfrytëzim jepet vetëm pjesa e parcelës në sipërfaqe prej 1900m² (një mijë nëntëqind metra katror), e evidentuar sipas certifikatës së pronësisë në posedim të Komuna e Rahovecit;
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim i pronës së paluajtshme të Komunës, të cekura në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronës publike komunale dhe zhvillimi i aktivitetit biznesor dhe tu jepet mundësi qytetarëve të vetëpunësohen, ku rritja e aseteve ekzistuese ndihmon në rritjen e vlerës së asaj prone.
4. Parcelat e cekur në pikën 1 të këtij propozimi sipas Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) 01 Nr. 2566 të datës 30.05.2013 ka destinim të përhershëm dhe gjendet brenda Zonës Ndërtimore.
5. Afati kohor për dhënie e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi, është afatshkurtër në periudhën prej pesëmbëdhjetë (15) vite.

6. Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Rahovecit dhe si e tillë ajo nuk mund t'i jepet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.
7. Çmimi fillestar i pronës komunale të cekur në pikën 1 dhe 2 të këtij vendimi mbi baza mujore, përcaktohet nga **komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës** sipas vlerës së përcaktuar në Rregulloren 01 Nr. 80/20 e datës 29.06.2020 për Taksa Komunale në Komunën e Rahovecit.
8. Obligohen Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë dhe Zyra e Prokurimit që në bashkëpunim me komisionin vlerësues të ofertave për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në Shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë që të zhvilloj procedurat e ankandit publik në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të procedurave të ankandit publik nga Komisioni për zhvillimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale afatshkurtër dhe afatgjatë, të përcaktoj me kontratë të veçantë të drejtat dhe përgjegjësitë e Komunës dhe përfituesit të pronës së dhënë në shfrytëzim.
10. Procedura për dhënien e pronës së paluajtshme në pronësi të Komunës në shfrytëzim afatshkurtër, realizohet përmes ankandit publik.
11. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural,*
- *Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.107/23
Me datë:31.7.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (e), nenit 51 paragrafi 51.2 dhe nenit 73, të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), dispozitave të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 34, 35, 36 dhe 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës së Rahovecit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.7.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për formimin e komisionit përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizara

1. Me këtë vendim **formohet** komisioni përzgjedhës për zgjedhjen e anëtarëve të Komitetit Konsultativ për Personat me Aftësi të Kufizara, në këtë përbërje:
 - 1.1. **Sinan Kryeziu** anëtar/e e Kuvendit – AAK;
 - 1.2. **Vlora Vuqiterna** anëtar/e e Kuvendit – VV;
 - 1.3. **Melinda Oruçi Iska** anëtar/e e Kuvendit – PDK;
 - 1.4. **Saranda Sallteku** anëtar/e e ekzekutivit
 - 1.5. **Valentina Krasniqi** anëtar/e e shoqërisë civile.
2. Detyrat dhe përgjegjësitë e komisionit janë të përcaktuara me Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 01/2016 për Procedurën e Themelimit, Organizimin dhe Kompetencat e Komiteteve Konsultative në Komuna.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01-Nr.109/23
Me datë:31.7.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17, nenit 24 dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”) dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 40 dhe nenit 94 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.7.2023 merr këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Memorandumit të Mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të Strehimores “Shtëpia e Sigurt”

1. Me këtë vendim **miratohet** Memorandumi i Mirëkuptimit për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të Strehimores “Shtëpia e Sigurt” me seli në Gjakovë.
2. Shuma prej **2,500.00€ (dy mijë e pesëqind euro)** për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve do të bëhet për periudhën 3 (tre) vjeqare dhe atë për vitet 2023, 2024 dhe 2025.
3. Obligohet Kryetari i Komunës që pas përfundimit të konsultimeve të hartohet draft marrëveshja për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të strehimores Shtëpia e Sigurt dhe e njëjta të nënshkruhet nga Kryetari i Komunës dhe përfaqësuesi/e i autorizuar i Strehimores.
4. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset Kryetari i Komunës.
5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Drejtorisë për Buxhet dhe Financa,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01Nr.110/23
Datë:31.7.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016”), Nenit 7 të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë, nenit 3 dhe nenit 4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 27/2012 MPB- 03/2012 për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, nenit 2, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 39 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.7.2023 miraton këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 265/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 265/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.
2. Pika 2.23 e vendimit bazik ndryshohet dhe formulohet me tekstin si në vijim:

2.23. Mustaf Korenica, anëtar nga Komuniteti i Bizneseve.
3. Ndërsa pikët tjera të vendimit bazik me numër 01 Nr. 265/22 i datës 25.01.2022 mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryesuesit të KKS-së,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

K U V E N D I I K O M U N Ě S N Ě R A H O V E C

01-Nr.112/23
Datë:31.7.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në bazë të nenit 12 pika 1 dhe 2 shkronja d), nenit 51 dhe nenit 53 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016”), në mbështetje të nenit 5 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë dhe nenit 2, nenit 10 paragrafi 2 pika 2.4, nenit 30, nenit 31 paragrafi 2, nenit 33 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i dt. 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.7.2023 miraton këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 263/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Komitetit për Poloitik dhe Financa, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin 01 Nr. 408/22 i datës 28.12.2022

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 263/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Komitetit për Poloitik dhe Financa, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin 01 Nr. 408/22 i datës 28.12.2022.
2. Pikat 1.1, 1.4 dhe 1.5 të vendimit bazik ndryshohen dhe formulohen me tekstin si në vijim:
 - 1.1. Arbër Zenuni - AAK, kryesues;
 - 1.4. Leonard Morina – LVV;
 - 1.5. Defrim Kafexhiu – LVV.
3. Ndërsa pikët tjera të vendimit 01 Nr. 263/22 i datës 25.01.2022 për themelimin e Komitetit për Poloitik dhe Financa, i ndryshuar dhe plotësuar me vendimin 01 Nr. 408/22 i datës 28.12.2022 mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- **Kryetarit të Komunës,**
- **Shërbimit të Kuvendit,**
- **MAPL-së, dhe**
- **Arkivit.**

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.111/23
Datë:31.7/2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit



Në mbështetje të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja (d), nenit 17, nenit 40, nenit 51 paragrafi 51.2 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008”), nenit 53 paragrafit 3 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016”), nenit 14 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr. 05/2020 për procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e komiteteve të përhershme dhe komiteteve tjera në Komunë, nenit 10 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 pika 2.4, nenit 34 dhe nenit 40 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kuvendi i Komunës në Rahovec në mbledhjen e mbajtur me dt. 31.7.2023 miraton këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 326/22 i datës 31.05.2022 për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale

1. Me këtë vendim ndryshohet dhe plotësohet vendimi 01 Nr. 326/22 i datës 31.05.2022 për përbërjen dhe organizimin e Komitetit për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
2. Pika 3.5 e vendimit bazik ndryshohet dhe formulohet me tekstin si në vijim:
3.5. Zana Omega, emërohet ekspert i jashtëm.
3. Ndërsa pikët tjera të vendimit bazik me numër 01 Nr. 326/22 i datës 31.05.2022 mbesin të pandryshuara.
4. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për shqyrtimin administrativ të akteve të komunave e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) Nr. 06/2021 dhe 7 ditë pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose Web – faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi u dërgohet:

- *Anëtarëve të Komitetit,*
- *Shërbimit të Kuvendit,*
- *MAPL-së, dhe*
- *Arkivit.*

KUVENDI I KOMUNËS NË RAHOVEC

01-Nr.113/23
Datë:31.7.2023

Arbër Zenuni

Kryesues i Kuvendit